



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERBAL

#### I përmbledhur<sup>1</sup>

Tiranë, më 16.09.2020, ora 13:00

#### Drejton mbledhjen

Vitore Tusha – zv/Kryetare e Këshillit

#### Rendi i Ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të përmbledhura të mbledhjeve të KED-së të datave 17.08.2020 dhe 21.08.2020.

2. Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatin për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.

- Altin Binaj
- Artan Spahiu
- Dedë Kasneci
- Gentian Mete

3. Diskutimi për vlerësimin e njoftimit të organeve të emërtesës, Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Shqipërisë, për rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, vakanca të parakohshme.

4. Diskutimi lidhur me “Njoftim qëndrimi” të përcjellë nga zoti Ardian Dvorani me e-mailin e datës 20.08.2020.

5. Vendimmarrja lidhur me lejimin/ndalimin e kandidimit të kandidatëve të mësipërm.

#### Marrin pjesë:

1. Vitore Tusha (zëvendëskryetare)
2. Fiona Papajorgji (anëtare)

<sup>1</sup> Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226, pika 1, shkronja “d”, neni 232, pika 2, neni 242, shkronja “c”) dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED-së për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe të subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED-ja disponon materialin e plotë audio dhe të zbardhur me shkrim të çdo mbledhjeje, sipas ligjit.

- |                   |           |
|-------------------|-----------|
| 3. Arta Marku     | (anëtare) |
| 4. Miranda Andoni | (anëtare) |
| 5. Saida Dollani  | (anëtare) |
| 6. Ludovik Dodaj  | (anëtar)  |
| 7. Fatjona Memçaj | (anëtare) |
| 8. Arjan Qafa     | (anëtar)  |

**Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :**

- 1. Erinda Ballanca, Avokat i Popullit, dhe Enio Haxhimihali,** përfaqësues i Avokatit të Popullit.

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:**

- 1. Bledar Dervishaj dhe Katrin Treska,** përfaqësues të Presidentit të Republikës, të pajisur me autorizimin nr. 446, datë 29.01.2020, lëshuar nga Presidenti i Republikës.
- 2. Korab Lita,** zëvendëskryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar “Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut” në Kuvend (opozita).

**Marrin pjesë, si të ftuar, në pikat 3 dhe 4 të rendit të ditës, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetës me konsulencë në procesin e hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore të KED-së:**

- 1. Michelle Lakomy,** këshilltare ligjore rezidente pranë OPDAT-it.

## **HAPET MBLEDHJA**

**Vitore Tusha** hap mbledhjen dhe bën me dije rendin e ditës që është publikuar në përputhje me procedurat dhe aktet e miratuara nga Këshilli. Verifikon praninë e anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje. Sugjeron që gjatë diskutimit për miratimin e rendit të ditës, të jenë në vëmendje vërejtjet e përcjella nga Presidenti i RSh, që lidhen me rendin e ditës, me çështjen e numrit të kandidaturave që janë përcaktuar për t’u shqyrtuar dhe mospërgatitjen e materialeve informuese dhe shpjeguese lidhur kryesisht me pikat tre dhe katër. Parashtron se materiali përcjell shqetësimin për vonesat dhe problematikat për ripërtëritjen edhe bërjen funksionale të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese dhe se i njëjti shqetësim është përcjellë edhe nga organi tjetër i emërtesës, Kuvendi i Shqipërisë. Zv/Kryetarja u shpreh: “Ne kemi të njëjtin vullnet për ta bërë sa më parë funksionale Gjykatën Kushtetuese, sigurisht duhet të shikojmë me vëmendjen e duhur sot, por edhe në ditët në vijim të gjithë problematikën e shfaqur, në mënyrë që të kemi mundësinë për të vijuar sa më shpejt dhe për t’i bërë këto mesazhe realitete, sepse, në fund të fundit, çdo mesazh që përcillet, është në funksion të

ngritjes dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese”. Fton anëtarët të diskutojnë dhe të miratojnë rendin e ditës.

Paraqet kërkesën e përfaqësueses të OPDAT-it, zonjës Michelle Lakomy, për të qenë e pranishme në këtë mbledhje lidhur me pikat tre dhe katër të rendit të ditës dhe kërkon mendimin e anëtarëve lidhur me këtë çështje.

**Fiona Papajorgji** për sa i përket çështjes së rendit të ditës për mbledhjen e KED-së, u shpreh për miratimin e tij siç është thirrur nga zëvendëskryetarja e KED-së.

Në lidhje me prezencën e përfaqësueses së OPDAT-it, është dakord të jetë prezente për pikat tre dhe katër të rendit të ditës.

**Miranda Andoni** është dakord për miratimin e rendit të ditës. Në lidhje me problematikat që janë shprehur në shkresën e Presidentit, përcjellë me shkresën e datës 15.09.2020, në përmbajtje të së cilës konstaton pyetje të drejtpërdrejta për relatoren në lidhje me shqyrtimin në mënyrë të veçuar të disa kandidatëve dhe jo të shqyrtimit njëherësh të të gjithë kandidatëve, sqaron se referuar vendimit për procedurat e verifikimit nr. 4, datë 11.03.2019, ka informuar kryetaren në lidhje me çdo kandidaturë, në momentin që ka përfunduar procedurën e verifikimit. “Duke respektuar renditjen sipas rendit alfabetik dhe faktin që për tre kandidaturat e para procedura e verifikimit ka qenë e përfunduar, vlerësova të informoj se këto kandidatura janë gati, ndërsa për kandidaturat në vazhdim konstatoj se ende nuk është përfunduar me procedurën e verifikimit. Besoj ditën e sotme ose në vijim do të kemi një përfundim edhe të procedurave për këta kandidatë, jo për të gjithë, dhe do të relatoj përfundimin e këtyre procedurave, me qëllim thirrjen e mbledhjes dhe vazhdimin e shqyrtimit të tyre. Arsyeja e vetme për të cilën unë kam qenë e detyruar të mos i relatoj të gjitha, ka qenë që nuk është përfunduar tërësisht procesi i verifikimit, kam pasur një arsye objektive, ndoshta nuk më takon ta them, kjo është arsyeja e mospërfshirjes të të gjitha kandidaturave për relativitet për ditën sotme. Po bëjmë të gjitha përpjekjet për t’i përgatitur sa më parë. Pothuajse të gjitha procedurat kanë përfunduar. Nuk do të vonojë asgjë.”.

Për sa i takon prezencën e përfaqësueses së OPDAT-it, nuk kam ndonjë kundërshtim.

**Saida Dollani** është dakord me miratimin e rendit të ditës.

Në lidhje me çështjen e dytë, shprehet se përderisa përgjatë të gjithë reformës në drejtësi të gjitha organizatat, institucionet janë ndihmuar nga përvoja shumë e vlefshme e përfaqësuesve ndërkombëtare, nuk ka asnjë kundërshtim.

**Ludovik Dodaj** është dakord me rendin e ditës, por për t’u dhënë hapësirë përfaqësuesve të EURALIUS-it dhe OPDAT-it, propozon të zhvendosen pikat një, dy dhe pesë në fund.

**Vitore Tusha** sqaron se do t'i lajmërojë në varësi të vendimit.

**Fatjona Memçaj** merr fjalën: “Për sa i përket rendit të ditës, nuk është thjesht një çështje që përmendet vetëm sot, miratimi i rendit të ditës, për mendimin tim, për arsye sepse kemi investimin e Presidentit të Republikës që e ka trajtuar me shumë hollësi dhe normalisht meriton vëmendjen tonë dhe një përgjigje për reagimin që ai ka paraqitur, sepse ka paraqitur të gjitha argumentet e tij, nëse nuk e kam të keqkuptuar, nëse unë kam keqkuptuar mund të më sqarojë përfaqësuesi. Pra, Presidenti i Rsh me sa e kam kuptuar unë, është për pikën e dytë të rendit të ditës, duke konsideruar se trajtimi në bllok i të gjithë listës për përfundimin e procedurës të verifikimit dhe vijimit për lejim apo ndalim kandidimi, është trajtimi që duhet bërë sipas ligjit, trajtimi në bllok, dhe është ky trajtim, i cili duke qenë i tillë, pra duke çuar emra të caktuar, siç shprehet në paragrafin e tretë të pikës 9, mos krijohet ndër të tjerë dyshimi se ka pasur një farë përzgjedhje.

Në këtë sens kemi shqetësimin e një organi emërtese, Presidentit të Republikës, që lista e emërtesës që do të bëjë ai, duke i qëndruar asaj që KED-ja është sekretariati i organit të emërtesës, pra funksionon për të theksuar, funksionon për të lehtësuar punën e organit të emërtesës dhe të gjithë procesin e verifikimit të kushteve ligjore edhe kritereve që parashikon ligji. E gjej shqetësimin e shprehur, një shqetësim me vend. Çfarë argumenti po japim ne që pse d.m.th.. kemi veçuar këto 4 kandidatura thjesht është çështje teknike, pra nuk kemi arritur dot të përfundojmë dot verifikimin. Nga ana e relatorit po na sqarohet, se ndërkohë është përfunduar i gjithë procesi i verifikimit, por nuk ka qenë e mundur të përfundohen aktet e fundit edhe për kandidatët e tjerë, sepse ndryshe do të kishim edhe kandidatë të tjerë sot me relacionet përkatëse, me gjithë aktet bashkëlidhur për përfundimin e procesit, të paktën kështu e kuptova unë në relatimin e zonjës Andoni. Duke qenë se ne mund ta plotësojmë këtë gjë, që të relatojmë në bllok të gjithë këtë listë dhe të mënjanojmë çdo lloj keqkuptimi të mundshëm për këtë pjesë, unë gjej që shqyrtimin e gjetjeve e verifikimi të kësaj liste ta shtyjmë për një moment të dytë, sa më të afërt, në bazë edhe të vlerësimit që relatori të këtë për atë se kur do të përfundohet tërësisht për të gjithë kandidatët e listës dhe t'i shqyrtojmë të gjithë bashkë në një mbledhje të caktuar, shumë më të afërt, në mbledhjen më të afërt të mundshme që teknikisht mund të realizohet. Pra, jam për të miratuar pikat 1, pikat 3, 4 dhe 5, duke shtyrë shqyrtimin e gjetjeve për një datë tjetër, duke shqyrtuar të gjithë listën që ne kemi në dorë për verifikimin, më pas për vendimmarrjen.

Për sa i përket pranisë së përfaqësuesve të EURALIUS-it, OPDAT-it, duke vlerësuar që kanë qenë shumë aktivë gjatë diskutimit të akteve normative dhe ka qenë asistenca e tyre, sepse edhe ligji kaq parashikon dhe duke parashikuar që mbledhjet tona janë mbledhje të

mbyllura, sipas detyrimit që ne kemi në ligj, unë do të isha për pranimin nëse do të diskutojmë për sa i përket pikës 3 për ndryshime të mundshme të rregullores. Po nëse thjesht kemi çështje të një vendimmarrje, a duhet apo jo, në kushtet e gjendjes aktuale ku ndodhet gjithë lista që duhet të sqarohet edhe nga relatorët, thjesht pra gjendja e faktit është e tillë që ne jemi në kushtet e zbatimit të rregullores për përcjellën te Presidenti dhe Kuvendi, atëherë vlerësoj se kjo nuk e është çështje që duhet të bëhet jashtë rregullave të mbledhjes së mbyllur.

Kurse për sa i përket prezencës së tyre në pikën 4, nuk kam ndonjë qëndrim. Unë për këtë pjesë, megjithëse duhet të jap mendim, sepse e kam detyrim me ligj, nuk shoh pse duhet të jenë apo pse nuk duhet të jenë, sepse do e diskutojmë më gjatë kur të diskutojmë edhe vetë qëndrimin tonë mbi këtë pikë.”.

**Arjan Qafa** shprehet dakord si zonja Memçaj për rendin të ditës. Për shkresën e përcjellë nga Presidenti shprehet se meriton vëmendje, pasi ka pasqyruar në tërësi situatën faktike të KED-së dhe problematikat që janë analizuar në krye të herës e në vijim deri sot.

Gjithashtu thekson se është dakord që të gjithë kandidatët të trajtohen në bllok për të hequr edhe keqkuptimet për pikën dy të rendit të ditës. Për sa u përket pikave tre dhe katër të rendit të ditës, është dakord të jenë të pranishme përfaqësueset.

**Vitore Tusha** pyet nëse do të vazhdohet me vendimmarrjen dhe po ashtu sqaron se verifikimi i kandidatëve të tjerë nuk ka përfunduar.

**Miranda Andoni** sqaron se janë pothuajse gati.

**Vitore Tusha** e rimerr fjalën: “Ka shkresa që kanë ardhur në datën 9 shtator, dhe janë përfshirë në relacione dhe menjëherë më datën 10 shtator është thirrur kjo mbledhje. Ka procedura të tjera të papërfunduara. Kemi pasur një problem, përveç meje, zonjës Memçaj dhe zonjës Marku, anëtarët e tjerët nuk kanë qenë të pajisur me certifikatë sigurie dhe janë dashur shumë procedura, të cilat kanë kërkuar kohën e tyre. Relatorja ka përcjellë ato relacione që kishte përgatitur. Shqetësimeve të ngritura do t’u japim të gjithë rëndësinë e duhur, të gjithë së bashku, për të respektuar jo vetëm problematiken që ngrihet, por edhe institucionin që na e ka përcjellë. Ne sot na duhet të miratojmë rendin e ditës dhe iu sjellë në vëmendje se , në materialin e parashtruar , nuk është kërkesë vetëm shtyrja e mbledhjes, siç tha znj. Fajtona, por edhe vijimi i saj duke qëndruar të mbledhur për të gjashta kandidaturat të cilat nuk janë të përfshira në rendin e ditës.”.

**Erinda Ballanca** merr fjalën: “Për hir të së vërtetës ne e kemi diskutuar këtë çështje. Në momentin e parë ju më keni komunikuar dhe më keni thënë se do të dorëzoni një pjesë të kandidaturave dhe unë personalisht, nisur edhe nga vullneti dhe dëshira e mirë që ne të ecim sa më shpejt në procedura, duke qenë se kjo është një kërkesë e përgjithshme e të gjithë

Shqipërisë, pavarësisht vullnetit tonë që ka qenë i patundur për t'u plotësuar sa më parë me kandidatët e duhur dhe të vlefshëm sipas parashikimeve ligjore dhe kjo është një gjë shumë e rëndësishme për të thënë, kam menduar se nuk kishte asnjë lloj problemi që ne ta bënim sa më parë. Duke krahasuar në kohë problematikat, edhe me një çështje tjetër në rastin e KLGJ-së, sepse të gjithë ashtu kanë ecur me miratimin ose jo të individëve rast pas rasti, kam një paralele në mendjen time dhe me faktin që për hir të së vërtetës unë nuk kam parë në atë moment ndonjë problematikë në lidhje me përcaktimin e rendit të ditës me katër anëtarë, ose me katër kandidatë, siç edhe ju e keni paraqitur. E vërteta është që dje morëm letër nga Presidenti i Republikës, i cili shprehu një argument ligjor. Ka një argumentim, në gjykimin tim, të qenësishëm, të cilit KED-ja duhet t'i japë zgjidhje: a qëndron apo jo në kuptimin ligjor detyrimi që KED-ja ka që pasi merr vendimin për miratimin apo rrëzimin e kandidaturës për efekt të lejimit apo ndalimit të kandidimit, ka vetëm një afat 5-ditorë për të bërë vlerësimin? A futemi ne në vlerësim menjëherë? A do të ndikojë kjo? Në këtë pikë do të doja që Këshilli të vlerësonte të bënte një diskutim pikërisht në lidhje me këtë pasojë. Unë nuk besoj se ka ndonjë qëndrim qoftë të relatorit, qoftë të kryetares në lidhje me faktin se kandidaturat e tjera s'do t'i lexojë, nuk ka asnjë arsyeje që ta mendoj unë këtë. E vërteta është dhe unë këtë po e them, që cilësia e relacioneve dhe gjetjeve, fatkeqësisht, ka penguar shpejtësinë. Unë kam një mal me gjetje, s'kam pasur asnjëherë në rastin konkret për dy nga kandidatët, sepse për Dedë Kasnecin dhe Gentian Mete nuk kemi më. Dhe vërtet ndoshta edhe nuk dilet me vendim, ndoshta KED-ja në përfundim nuk ka me asnjë vendim përfundimtar dhe ndoshta e shtyn për verifikime të mëtejshme. Në gjendjen aktuale të akteve ka një sërë çështjesh të cilat janë për t'u trajtuar, pra unë këtë qëndrim do të ndaja. Unë dua të them se nuk është çështja e mungesës së vullnetit, pasi sigurisht nuk ka debat që vullneti i kryetares në detyrë është që ky proces të ecë sa më parë dhe KED është nën presion shumë të madh popullor, kur them popullor, d.m.th. të kërkesës që njerëzit kanë vërtet nevojë për të pasur gjykatë. Ndoshta edhe ky është problemi i KED-së, që ne nuk kemi qenë aq vokale sa duhet, aq të zëshëm për të treguar pengesat e mëdha që ky organ ka, qoftë në nivel strukturor, qoftë në nivel të kapaciteteve, qoftë në nivel administrativ, qoftë në nivel që u kthye përsëri në një organ që s'ka asnjë fond por kërkohet që të bëjë një punë shumë të madhe, qoftë dhe për faktin se kriteret ligjore nuk lejonin kandidimin e shumë e shumë kandidatëve, dhe që duhet të ketë, siç edhe ka pranuar KED-ja, të bëhen ndryshime qoftë kushtetuese, qoftë ligjore. Pra janë disa gjera të cilat KED mund të kishte qenë me e zëshme për ti trajtuar dhe gjithashtu përfaqësuesit e organeve të emërtesës, si Kuvendi dhe Presidenti, mund të kishin qenë më të artikuluar për ta zgjidhur këtë çështje. KED përveçse vonesave apo mosfunksionimit gjatë

periudhës shkurt-qershor për arsye të cilat ndoshta do duhet t'i vlerësoni dhe verifikoni ju si organ së brendshmi, ka qenë organ i cili ka punuar në mënyrë shumë të dedikuar në lidhje me ato kapacitete ato mundësi që ka pasur dhe në gjykimin tim përtej kapaciteteve që janë, ose përtej pritshmërive që janë për një organ ad-hoc. Nuk di realisht një organ tjetër që të ketë punuar me këtë vullnet siç është KED-ja, por me duhet që të them se nga ana tjetër ka një argument në lidhje me procedurat të cilat duhet të zgjidhen. Nëse zgjidhim procedurat mendoj që mund të vijohet me çështje të rendit, por nuk ka lidhje me mungesën e vullnetin, pasi duam të ecim sa më parë dhe ndoshta mund të kishte një vëmendje apo një argumentim me të thellë.

Ndërsa për sa i përket pikës së tretë të rendit të ditës, jam dakord që të mbetet, për sa u përket dy vakancave të tjera do mbetet, por duhet të kemi një relacion, duhet të kemi një qëndrim, duhet të kemi një argumentim çfarë do të bëhet për rastin konkret. Në lidhje me pikën 4 të rendit të ditës dhe pikën 5, gjithashtu jam dakord që të jenë në rendin e ditës, por në pikën 4 do të doja të ishin prezentë të gjithë, edhe anëtarët zëvendësues, sepse kanë qenë kur janë diskutuar çështje parimore, kur nuk kanë pasur të bëjë me vendimmarrje konkrete individuale KED-ja ka qenë me formën e saj të plotë, anëtar edhe anëtare zëvendësues edhe në mbledhjet e para të vitit 2019, edhe në vitin 2020, qoftë edhe në momentin që është diskutuar edhe çështja e zonjës Marku, që ka disa ngjashmëri në lidhje me këtë aspekt.

Për sa i përket prezencës së EURALIUS-it, OPDAT-it, pa i hequr asnjë pikë besimit shumë të madhe që ne kemi tek dy misionet asistencë, sepse kanë bërë të mundur një pjesë shumë të madhe të reformës në drejtësi dhe kanë marrë meritën për një pjesë shumë të madhe të reformës në drejtësi, mendoj se vetë e kanë shkruar ligjin dhe vete e kanë interpretuar ligjin që nuk mund të marrin pjesë.

Unë jam pro transparencës, por duke qenë se Këshilli ka konsideruar se ka pengesë ligjore, do të krijohet precedent, pasi edhe institucione të tjera si Komiteti i Helsinkit, apo Komisioni i Monitorimit të Reformës në Drejtësi pranë Kuvendit, do rikërkojnë të marrin pjesë.

Vendimi është juaji, por mendoj se Këshilli duhet të vlerësojë konsekuencat nëse i trajton nga këndvështrimi nëse ka apo jo nevojë të ndryshohen dispozitat e rregullores në lidhje me veprimin që duhet të ndërmerret Këshilli kur bie numri i kandidaturave. Sigurisht ju jeni ekspertë të ligjit dhe mundet ta vlerësoni por mendoj se nuk është pa bazë dhe argumentimi ligjor që ne të lejojmë apo mundësojmë ndonjë lloj debati apo diskutimi, cili mund të cenojë vendimmarrjen përfundimtare të KED dhe besimin publikut tek ky institucion. Besoj se duhet të mënjanojmë çdo diskutim apo debat i cili të rrezikojë përpjekjet e jashtëzakonshme dhe

punën e dedikimin e secilit prej jush në ushtrim të kësaj detyre. Garantoj është vullnet i përditshëm pune, lodhje, dhe orë të tëra. Ju faleminderit.

**Bledar Dervishaj** merr fjalën: “Nga diskutimet e deritanishme rezulton se jo të gjitha çështjet që ka ngritur Presidenti janë evidentuar nga anëtarët. Ka disa çështje edhe me të rënda, që unë do t’i parashtoj. Nuk mund të kalohen formalisht përmes miratimit të një rendi dite çështjet që ka ngritur Presidenti. Çështjet e ngritura janë thelbësore.”.

**Vitore Tusha** ndërhyr : “Duke mos dashur që t’u ndërpres fjalën , më duhet të sqaroj se : Unë evidentova dy çështje që lidhen me vijimësinë e procedurës ditën e sotme dhe kërkova që gjithsecili ti ketë në vëmendje këtë në momentin që do ta diskutojmë. I gjithë materiali i përcjellë do të marrë vëmendjen e duhur dhe do të ketë një përgjigje të saktë për çdo gjë që është ngritur. Në këtë moment nuk kemi mundësi objektive për ta bërë këtë gjë. Unë u përqendrova vetëm në ato çështje që lidhen me vijimësinë e mbledhjes së sotme, por në material ka çështje që s’lidhen me vijimësinë e kësaj mbledhje. Përsëris se, çdo shqetësim që është adresuar, do të merret me seriozitetin më të madh. Nuk do të doja të isha e keqkuptuar, pastaj e drejta juaj për të folur është si ta vlerësoni.”.

**Bledar Dervishaj** merr fjalën: “Kjo letër e Presidentit është një letër jo pa qëllim e një letër e gjatë. Për të kujtuar se çfarë ka ndodhur në periudhën 2017-2018, për të rifreskuar memoriën e problematikës së funksionimit të Këshillit në vitin 2019, ku një pjesë e mirë e anëtarëve të tij, janë dhe sot anëtarë të këtij KED, dhe për t’i kujtuar këtij Këshilli që është në kufijtë, thotë Presidenti, të shkeljes së ligjit (të paligjshmërisë). Unë habitem se si mund të shqyrtohet e të ngrihet tani miratimi i rendit të ditës, kur çështja e rendit të ditës duhet të ishte konsultuar paraprakisht nga anëtarët e Këshillit, dhe sa për pakësim mund të futen për miratim, në vlerësimin tim, sipas rregullores që ka miratuar vetë Këshilli. Çështja kryesore, ose e para që ngriti Presidenti, ka të bëjë me ndarjen dhe shqyrtimin e kandidatëve në dy faza!, mund të jenë edhe tre. E dyta, Presidenti ka evidentuar disa paqartësi dhe për këtë ka ngritur disa pyetje, duke argumentuar njëkohësisht se, është relatorja e vakancës ajo që i paraqet Kryetares së Këshillit relacionet e gatshme për shqyrtim. Nga shpjegimet që dha relatorja, nuk dëgjuam ndonjë arsye objektive se përse është ndarë kështu lista e kandidatëve për shqyrtim. Dhe për këtë çështje ne kemi bërë arsyetimin tonë ligjor, duke evidentuar se cili është risku i shkeljes së ligjit dhe çfarë implikimesh duket se mund të ketë në këtë çështje. Pyetja normale që bëhet është: A përshejtohet procesi duke i ndarë shqyrtimin e kandidatëve në dy faza? Në vlerësimin tonë, Jo, nuk e përshejton. Por sërish për këtë çështje, Presidenti nuk ka kërkuar “shtyrje”, por i ka kërkuar këshillit “Qëndro i mbledhur”, vijo veprimtarinë në mënyrë të pandërprerë, për të nxitur procesin dhe për të ecur më shpejt. Përveç sa ngrihet në



këtë shkresë të Presidentit, unë si përfaqësues i Presidentit, gjatë mbledhjeve të kaluara e kam pyetur relatoren dhe gjithë Këshillin, që prej mbledhjes së 30 qershorit dhe në të gjitha mbledhjet e tjera: “Ku jeni me shqyrtimin vakancës sonë, ku jeni, ku jeni?” dhe asnjëherë s’kam pasur përgjigje që jemi në këtë fazë, kemi këtë pengesë, apo atë pengesë! Sot një nga pengesat u bw me dije nga zëvendëskryetarja, që për mua është një fakt akoma dhe më i rëndë, shumë i rëndë madje, po të bëjmë krahasimin me ato prova që kemi thënë. Një pjesë e mirë e anëtarëve të KED-së nuk kanë çertifikatë sigurie!”.

**Vitore Tusha** sqaron se e kanë marrë ditën e enjte.

**Bledar Dervishaj** rimerr fjalën duke sqaruar: “Më lejo të vazhdoj fjalën time se është një fakt shumë i rëndë. Pse? Jo për anëtarët, por për organin që kryen procesin e çertifikimit. Nëse do të shikojmë relacionet e secilit kandidat, përgjigjja ka qenë njëlloj për të gjithë, psh. Altin Binaj, Artan Spahiu... Më 28.02.2019, ka kthyer përgjigje DSIK për verifikimin tyre, ndërkohë që për relatoren dhe anëtarët e Këshillit është mbajtur peng pajisja e tyre me certifikatë sigurie?! Ky është një tjetër fakt që ne si institucion nuk kishim dijeni. Por ai organ (DSIK) varet nga Kryeministri, nuk varet nga Presidenti. Ne i kemi kërkuar KED-së, bashkë me Kuvendin se cilat janë pengesat që Këshilli po has? Në mënyrë që përmes reagimeve zyrtare Presidenti dhe Kuvendi mund të ndikonin në kapërcimin/zgjidhjen e tyre. Ky fakt që doli sot, është shumë i rëndë.

Lidhur me çështjen e shqyrtimit të kandidaturave, ne kërkojmë që Këshilli të qëndrojë i mbledhur dhe të përfshihen edhe 6 kandidaturat e tjera, të punohet me të gjitha ritmet, këshilltarët të vendosen në dispozicion të Këshillit, relatorja po ashtu, çështjet duhet të shqyrtohen dhe të mbarojnë bashkërisht në të njëjtën kohë, në mënyrë që këto dispozita të ligjit që ne kemi cituar në shkresë të respektohen. Në të kundërt do ketë shkelje të ligjit, është e sigurt që s’ka ku shkon ndryshe, nëse shqyrtimi ndahet në faza.

Për çështjen tjetër të rendit të ditës, këtu flitet se për çfarë mund të bëhet me tutje për dy vakancat e tjera të parakohshme. Ne kemi evidentuar disa pyetje në shkresën që ju administroni. Kandidatët e fundit të ngelur në garë për këto dy vakanca, zonja Panajoti dhe zoti Shaqiri, janë shqyrtuar nga këshilli respektivisht në datat 17, 21 gusht 2020. Kur njoftohemi për një rend dite të caktuar duhet të ketë dhe një informacion nga relatori/rët për këto dy vakanca, ose të zbardhet ecuria procedurale duke pasqyruar që, u njoftuan kandidatët, ka kaluar afati ligjor për ankim, nuk ka kaluar, e ka kundërshtuar në gjykatë ose nuk e ka kundërshtuar. Ky informacion duhet të ishte pjesë e tryezës si për anëtarët e këshillit, edhe për ne si organ emërtese. Kjo për të kuptuar ecurinë procedurale. Herën e kaluar kemi qenë edhe ne në procesin gjyqësor që është zhvilluar. Pra ishte e pritshme nga ne,

që të kishim një informacion që ju nuk e keni hartuar. Edhe kjo është një e metë e rëndë që evidentohet në këtë rend dite dhe patjetër që duhet të qëndrojë për ta diskutuar. Nuk e ka kundërshtuar njeri këtë pikë të rendit të ditës, por janë të meta procedurale, që kanë lidhje me vendimmarrjen e Këshillit, nuk ka lidhje me ne.

Çështja tjetër pa u ndalur gjatë, sepse është ndalur vetë Presidenti në disa letra, për përfshirjen në diskutim të qëndrimit që ka shprehur ish-anëtari i Këshillit, ish-anëtari i Gjykatës së Lartë, zoti Dvorani. Kjo është arsyetuar qartë edhe në letrën që Presidenti ka paraqitur sot, por jo vetëm në këtë letër, por edhe në atë të datës 10 prill (2020), që duhet të ishte pjesë e tryezës, por edhe në letrën tjetër të dërguar më 4 shtator dhe në këtë letër që diskutojmë sot. Qëndrimi ynë është që, kjo nuk është një çështje për t'u diskutuar nga ana e Këshillit, jo për vendim, jo e jo, por as për diskutim. Këshilli nuk e zgjidh dot këtë çështje. Ajo që ne kemi parë si juristë është që, pas këtij diskutimi formal, këtu në Këshill, mund t'i lihet si mundësi vlerësimi për të qenë prezent ose jo, një ish-anëtari që s'ka të drejtë të jetë prezent. Kjo do të mund ta vendoste konfliktin në mënyrë të habitshme. Atëherë të lind pyetja: nëse në mbledhjen e radhës, pas kësaj logjike diskutimi, nëse ky ish-anëtar i KED, do të jetë prezent në Këshill, a njihet nga Këshilli, nga pjesa tjetër, si anëtar? Pra, edhe vet diskutimi që KED mund të realizojë sot, në vetvete prek themelin. Për këtë, ne jemi shprehur që kjo çështje nuk mund të ishte pikë e rendit të ditës. Një çështje akoma më të rëndësishme, siç e kemi evidentuar si shqetësim, është prezenca e Avokatit të Popullit, (përfaqësuesit të tij) që në mbledhjen e kaluar ka pasur diskutim, nëse përfaqësuesi i autorizuar duhet të jetë, apo s' duhet të jetë prezent. Ky debat e rikthen KED prapë në modelin e vjetër. Ndjesë Erinda se po të citoj emrin, a lejohet Erinda Ballanca me detyrë Avokati i Popullit të jetë prezent apo Avokati i Popullit përfaqësuar nga zotëria Enio Haxhimihali? Procedura dhe ligji nuk flet as për emrin Ballanca, as pararendësin e saj, as pasardhësin e saj. Ligji flet për institucionin e Avokatit të Popullit që është një, që ka një emër drejtuesi ai patjetër, është personi që e ushtron këtë detyrë, i cili ka autorizim në rast mungese objektive. Por t'i thuash: largohu se ti si përfaqësues nuk e ke këtë drejtë, por e ka personalisht veç Avokati i Popullit, neve na duket e papranueshme dhe për këtë arsye e kemi ngritur si çështje në letrën që ju ka mbërritur. Këto ishin çështjet kryesore që Këshilli do të kalojë pikë pas pike të rendit të ditës. Për sa i takon pyetjes për kërkesën e përfaqësues së OPDAT-it që të jetë prezent, është në vlerësim të Këshillit. Avokati i Popullit bëri një rikujtesë mbi qëndrimin mbajtur nga institucionet ndërkombëtare të ekspertizës se kush duhet të jetë prezent. Unë mbaj mend shumë mirë sepse kam qenë këtu në vitin 2019-2020, ku EURALIUS ka thënë deri që, as Avokati i Popullit nuk duhet të marrë pjesë në diskutimet e Këshillit dhe kundërshtoi

prezencën e Avokatit të Popullit. Ky Këshill nuk e ka pranuar Komisionin e Monitorimit të Sistemit të Drejtësi të jetë prezent në mbledhjet e Këshillit etj. etj. Nuk di të them, por kjo çështje ngelet në vlerësimin tuaj. Presidenti në fund të ditës përmes letrës që ju keni administruar, ka kërkuar përsheptim, përsheptim të procesit. Dhe nuk e ka kërkuar sot, e ka kërkuar në tre vjet radhazi, mos të them katër, por tre po. Çështjet që janë përmendur në letër mund të krijojnë shteg që ky proces të zvarritet, prandaj Presidenti e ka parë situatën me shqetësim, me rrezik, dhe ka bërë, siç thotë një kolegu ynë i USAID, “*a good reminder*”- “*një kujtesë të mirë për këshillin*”. Pastaj Këshilli të veprojë vetë sipas atij vlerësimi, siç tha zëvendëskryetarja që do ta bëjë secili anëtar i tij. Por Presidenti si organ emërtese dhe në cilësinë e Kryetarit të Shtetit, përderisa situata ka ardhur kështu, u desh që përmes kësaj letre të kujtojnë edhe KLGJ-në për vonesat e emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, por edhe KED-në, që si rend dite të mbledhjes ka çështje që lidhen me procesin e emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.”.

**Vitore Tusha** merr fjalën dhe sqaron se, përfaqësuesi i Presidentit, nuk ka qenë prezent pas mbylljes së mbledhjes së shkuar, në momentin që Këshilli do të vazhdonte me vendimmarrjet dhe se, çështja që ngrihet, në lidhje me praninë e avokatit të popullit, nuk është përcjellë e saktë. Shpjegon se zoti Enio ka qenë i pranishëm dhe në mbledhjen e shkuar, dhe konfirmimin për praninë e tij e kishte dhënë Avokati i Popullit, por ndërkohë Enio nuk i paraqiti Këshillit, autorizimin sipas kërkesave ligjore me argumentin, që ky dokument megjithëse ishte i përpiluar nga titullari nuk e kishte te mundur ta merrte në institucion. Në kuptim të Ligjit, si subjekte që marrin pjesë në mbledhje të KED-së parashikohen përfaqësues të autorizuar të Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Kuvendit, ndërsa për Avokatin e Popullit nuk bën të njëjtin rregullim në kuptimin e përfaqësimit. Gjithashtu shpjegon se asnjë nga anëtarët e Këshillit nuk i ka thënë Enios të largohet nga mbledhja.

**Korab Lita** merr fjalën duke u shprehur se është dakord me rendin e ditës, përveç pikës dy. Vëren se shkresa e Presidentit përveçse një shqetësim, është edhe një shkak për një fare analizë në lidhje me çështjen. Nga Presidenti dhe Kuvendi janë dërguar kandidaturat prej më shumë se një viti në KED, ndërkohë që janë sjellë vetëm katër kandidatura për shqyrtim. “Mendoj se duhet gjetur arsyeja ose diskutuar pse është e gjithë kjo vonesë, ndërkohë që të gjithë jemi koshientë për nevojën e madhe që ka për formimin e institucioneve të drejtësisë në Shqipëri. Cila është arsyeja që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk po verifikon dot kandidaturat? Ndoshta ka institucione që nuk përgjigjen ose nuk e di, se duhet shkaku, pasi besoj se kjo vonesë e gjatë është e papranueshme.

Për sa u përket kandidaturave, unë mendoj se duhet të sillen bllok, për të shmangur çdo keqkuptim, çdo iluzion, qoftë të publikut apo institucioneve në lidhje me trajtimin e drejtë të këtyre kandidaturave.”

**Mimoza Arbi** sqaron se është vënë në dijeni nëpërmjet *e-mailit* për mbledhjen dhe rendin e ditës, si dhe për letrën që Presidenti i Republikës i ka drejtuar KED-së. Shprehet se e mbështesin tërësisht të gjithë problematikën dhe shqetësimet që ka ngritur Presidenti i Republikës, pasi janë shqetësime që janë ngritur edhe nga kryetari i Kuvendit qoftë në takimet që ka pasur, qoftë në letrën drejtuar KED-së kohë më parë në lidhje me shpejtësinë e procesit të verifikimit dhe të vlerësimit të kandidatëve. Si përfaqësuese e Kryetarit të Kuvendit, duke qenë pjesë e mbledhjeve shprehet se është në dijeni të arsyeve të këtyre zvarritjeve, shqetësimeve, të cilat ia ka bërë me dije Kryetarit të Kuvendit, megjithëse asnjë prej tyre nuk justifikon zvarritjen e gjatë që ka pikërisht procesi i verifikimit dhe vlerësimit të kandidatëve.

Për sa i përket pikës 2 të rendit të ditës, ajo shprehet: “E gjej me vend aspektin procedural që sjell pikërisht shqyrtimi i shkëputur i këtyre kandidaturave dhe gjykoj se këto kandidatura duhet të gjykohe në bllok për të mos pasur pikërisht problem në lidhje me interpretimin e aspektit procedural të përmendur edhe në letrën e Presidentit që bëhet duke referuar pikërisht dispozitat e nenit 237 -238-239 e në vijim, që përcakton afatet konkrete mbi të cilat rrjedh edhe vendimmarrja e KED-së. Për sa i përket pikës 3, edhe aty e mbështet Presidentin e RSh, sepse kur është vënë rendi i ditës që do të shqyrtohet, kërkesa që KED-ja do t’i dërgojë organit të emërtesës, siç është Kuvendi, për vendin vakant të shpallur në datën 21.08.2018, për të cilin aktualisht nuk ka kandidatë, por ne duhet të kishim një informacion më të plotë në lidhje me fazën në të cilën është procedura e ankimimit të këtyre kandidatëve të fundit, për të cilën nuk e kishim dhe nuk e kemi këtë informacion, prandaj dhe e quajmë me vend shqetësimin e tij.

Në lidhje me shqetësimin e Presidentit, për interpretimin që bën për pikën 4 të rendit të ditës, unë gjykoj se nuk jemi ne si organ të këshillojmë KED-në si do të veprojë, është KED-ja, e cila bazuar në letër ka vendimmarrjen e saj nëse shqyrton apo jo dhe është KED-ja ajo që referuar pikërisht aspektit ligjor vendos se çfarë do të bëhet me këtë kërkesë. Këto janë shqetësimet që përherë ka ngritur edhe Kryetari i Kuvendit. Edhe në çeljen e sesionit të vjeshtës, që ishte të hënën e parë të muajit shtator, ngriti shqetësimin për funksionimin e Gjykatës Kushtetuese. Ky është shqetësim jo vetëm i institucioneve të emërtesës, por mbarëpopullor. Ai deklaroi që të paktën viti i ardhshëm ta gjejë të ngritur dhe të konstituuar Gjykatën Kushtetuese në aspektin e funksionimit të saj. Kuvendi ka bërë gati një sërë

problematikash, qoftë në aspektin ligjor, qoftë në aspektin faktik, që synojnë shpejtimin e procedurës për emërim për kandidatët që kandidojnë për vendet vakante të Gjykatës Kushtetuese. Momentalisht s'mund të shprehem se cilët do të jenë hapat që do të marrë Kuvendi në aspektin e kuadrit ligjor. Ndërsa për sa i përket aspektit të bashkëpunimit të KED-së me institucionet me të cilat ajo merr informacion gjatë kohës së verifikimi dhe shqyrtimit të kandidatëve, Kuvendi, e kemi shprehur dhe në mbledhjen tjetër, është hapur që të gjitha këto shqetësime t'i ngremë dhe të vëmë në lëvizje pikërisht këto organe për t'iu përgjigjur brenda afateve afate kohore të shkurtra të gjitha kërkesave që KED-ja u drejton atyre në kuadër të verifikimit dhe vlerësimit të kriterëve të kandidatëve. Këto janë pikërisht disa problematika, por sinqerisht Kryetari i Kuvendit është i shqetësuar dhe ka ngritur këtë shqetësim për bërjen sa më parë funksionale të Gjykatës Kushtetuese.”.

**Arta Marku** është dakord me rendin e ditës, ndërsa në lidhje me problematikat e ngritura në shkresën e Presidentit që i është drejtuar Këshillit, mendon të fokusohet tek pjesa që i përket në lidhje me kandidatët Regleta Panajoti dhe Shaqir Hasanaj.

Për sa i përket prezencës së zonjës Mischelle të OPDAT-it mendon se nuk përbën ndonjë problem, nuk cenohet asnjë parim. Nëse ka shprehur dëshirën të jetë pranishme, të jetë e pranishme, natyrisht aty ku mund të jetë e pranishme.

**Ludovik Dodaj** e rimerr fjalën për të diskutuar për rendin e ditës: “Unë u shpreha në parim për rendin e ditës dhe janë detaje të cilat u shprehen nga kolegët, Avokati i Popullit, përfaqësuesi i Presidentit dhe përfaqësuesja e Kuvendit. Unë si anëtar i Këshillit kam një merak për veten time, se ndoshta të tjerët janë më të rinj dhe i kanë mundësitë, në këto lloj rastesh kur kemi edhe letrën e Presidentit, edhe ndërhyrjen e organeve të tjera, është mirë që këshilltarët të vihen në lëvizje që të nxjerrin dispozitat ligjore që të na bëhen të qarta, se me ngarkesën që kemi në punën tonë, nuk mund t'i nxjerrim. Unë gjej te letra e Presidentit që është një pengesë për pikën e dytë, pesëditëshi që duhet të shprehim për përfundimin e procedurave të verifikimit. Ky afat pengon për të kaluar te vlerësimi i pikëzimit që duhet të jetë në bllok. Këtë mund ta analizojmë ne sot në pikën 2? Unë mendoj të shprehemi dhe të mos biem në përsëritje, por që është tepër pengesë, nëse nuk janë të gjithë, ky afati pesëditor. Është problem, se duhet të jenë dhe zëvendësuesit për pikën 4 që duhet të diskutojmë. Mendoj të vendosim se për cilat pika do të shprehemi sot, se kjo është ngarkesa jonë, përgjegjësia jonë, pavarësisht pjesë e dispozitivit që është nga të gjithë.”

**Vitore Tusha** duke sqaruar se materiali u është komunikuar të gjithëve njëherësh pasditen e djeshme thekson se “Unë prezumoj se ju keni në vëmendje të gjithë legjislacionin, të gjitha aktet normative . Mënyra se si ka funksionuar KED-ja edhe vitin e shkuar ka rëndësi,

për praktiken e ndjekur. Kemi pasur vakanca, me 22 kandidatë, konkretisht vakanca e Kuvendit e datës 12 shkurt 2018, dhe kandidatët nuk janë shqyrtuar në bllok. Ato janë grupuar e relatuar sipas problematikave dhe këtë e them me përgjegjësi, pra një grup kandidatësh për të cilët dokumentet nuk ishin dërguar në kohën e duhur, dhe një grup kandidatësh të cilëve iu përfundua verifikimi me shpejt. Mbi të njëjtën praktikë grupuam kandidatët që paraqitëm për t'u shqyrtuar në këtë mbledhje. Kjo është mënyra se si është interpretuar ligji dhe si janë verifikuar rastet konkrete dhe mbi të cilat KED-ja ka vendosur. Unë ndjeja përgjegjësi, prandaj mbledhjen e orientova drejt thelbit, dhe e hodha në diskutim këtë çështje. Është në të drejtën tuaj të vendosni.”.

**Fiona Papajorgji** merr fjalën: “Meqenëse hymë në diskutim të themelit të çështjes fillimisht mendoj se nga Rregullorja e KED-së është detyrim jo vetëm për kë e thërret mbledhjen të vërë në dispozicion të të gjithë anëtarëve rendin e ditës, vendin dhe orën e zhvillimit të saj, si dhe të gjitha materialet, të paktën 5 ditë para zhvillimit të mbledhjes. Sot gjendemi përpara një shkrese që na është përcjellë në rrugë elektronike dje në orën 17:00, për të cilën unë mendoj se duhet të shprehemi vetëm për sa i takon rendit të ditës, edhe sepse, me sa kuptova unë nga zëvendëskryetarja, mu duk e drejtë qasja që duhet të diskutojmë dhe të gjejmë mënyrën që t'i japim një përgjigje të detajuar kësaj shkrese. Për sa përket thelbit, na përket në radhë të parë ne, anëtarëve të KED-së, shqetësimi i shprehur nga të gjithë pjesëmarrësit në mbledhjet e KED-së, për ngritjen sa më shpejt të jetë e mundur të Gjykatës Kushtetuese. Mbase e pranoj kritikën që bëri Avokati i Popullit që KED-ja nuk i ka dhënë shumë zë punës së kryer, por është kryer një punë voluminoze për sa kemi mundur dhe sa kemi pasur.”

**Erinda Ballanca** sqaron se ka thënë të kundërtën.

**Fiona Papajorgji** sqaron: “Pikërisht flas që nuk i kemi dhënë zë, por besoj të gjithë këtu e dimë. Për sa i përket pikës 2 të rendit të ditës dhe pretendimit të ngritur për të shqyrtuar në bllok të gjitha kandidaturat, mendoj se ligji dhe aktet nënligjore të KED-së në asnjë dispozitë nuk përcaktojnë se duhet bërë shqyrtimi i gjitha kandidaturave së bashku. Përkundrazi, vendimi nr. 4 i KED-së, në pikën 50, përcakton edhe mundësinë që nëse dalin akte të tjera që duhet të kryhen, të pezullohet procedura, që do të thotë që nuk është e thënë të mbyllet dhe të verifikohen të gjitha brenda ditës. Kur kjo procedurë verifikimi mbyllet, pikëzimi duhet të bëhet për të gjithë kandidatët e lejuar. Kjo është bërë në një bilancim të interesave ndërmjet shpejtësisë që na kërkohet dhe përgjegjësisë që duhet të tregojmë në shqyrtimin e kandidaturave. Nëse do të mendonim se mund të ishin 100 kandidatura, si do të mund t'i përballonim, me gjithë vullnetin për të ndenjur të mbledhur, qoftë edhe natën, por

nuk mendoj se do të kishim kthjelltësinë që të shqyrtonin 100 kandidatura njëherësh. Kështu që mbi të gjitha, unë mendoj se prevalon të japim produktin. Ndaj nuk shoh probleme me miratimin e këtij rendi dite.”.

**Saida Dollani** thekson se edhe ajo ka votuar në parim dhe vazhdon t'i qëndrojë parimit, duke pasur në konsideratë pikën 14 të vendimit 5 të KED-së, të cilën e lexon: *“Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve, nëpërmjet vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së tyre nga Këshilli, fillon me thirrjen e mbledhjes, e cila zhvillohet jo më vonë se 5 ditë nga ajo e përfundimit të procedurave të verifikimit të të gjithë kandidatëve që kanë shprehur interesin pranë të njëjtit organ emërtese që ka shpallur vendet vakante”*. Duke u shprehur se e kombinon këtë dispozitë me dispozitat ligjore si dhe nënligjore të vendimit nr. 4 të KED, thekson se përfundimi i procedurave të verifikimit përkon me të fundit kandidat të verifikuar. Gjithashtu shprehet se, referuar ligjit, që përcakton mandatin një vjeçar për KED, duke përcaktuar kështu se prevalon parimi i shpejtësisë së procedurave të verifikimit, e konsideron shumë të denjë veprimin e relatores që menjëherë sapo ka përfunduar një relacion ia paraqet Këshillit, duke dhënë kështu edhe për opinionin publik besimin që Këshilli po funksionon në kryerjen e detyrës së tij.

**Vitore Tusha** vë në dukje që akti normativ 4 flet për këtë proces që po bëjmë, ndërsa 5-a flet për procesin tjetër, për renditjen për pikëzimin dhe vijon me votimin e rendit të ditës.

**Anëtarët e Këshillit**, në përfundim të diskutimeve për rendin e ditës, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Fiona Papajorgji, Miranda Andoni, Arta Marku, Saida Dollani, Ludovik Dodaj dhe Vitore Tusha janë dakord me rendin e ditës. Fatjona Memçaj dhe Arajan Qafa janë dakord me rendin e ditës me përjashtim të pikës 2.

**Vitore Tusha** përmbledh diskutimet lidhur me praninë e përfaqësueses së OPDAT-it dhe shprehet se “Diskutimi kishte dy nuanca: njëra ishte që të jenë prezente, tjetra që të jenë vetëm gjatë diskutimit abstrakt të pikës tre. Kjo çështje ka natyrë abstrakte, në mënyrën e interpretimit, por dhe konkrete. Kjo ishte nuanca që u shfaq edhe nga zonja Memçaj, dhe më pas nga Arjani.” Fton në votim anëtarët.

**Anëtarët e Këshillit** janë dakord që përfaqësuesja e OPDAT-it të jetë prezente gjatë diskutimit të pikave tre dhe katër të rendit të ditës.

**Vitore Tusha** vijon me pikën e parë të rendit të ditës “Miratimi i procesverbaleve të përmbledhura të datave 17.08.2020 dhe 21.08.2020 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi” dhe fton anëtarët t'i miratojnë.

**Këshilli** vijon me miratimin e tyre.

**Vitore Tusha** hedh në votim miratimin e procesverbalit të përmbledhur të mbledhjes së datës 17.08.2020.

**Anëtarët e Këshillit** miratojnë procesverbalin e datës 17.08.2020.

**Vitore Tusha** hedh në votim miratimin e procesverbalit të përmbledhur të mbledhjes të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi së datës 21.08.2020.

**Anëtarët e Këshillit** miratojnë procesverbalin e datës 21.08.2020.

**Vitore Tusha** vë në dukje se të dyja procesverbalet do të publikohen menjëherë në faqen zyrtare të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe vijon me pikën e dytë të rendit të ditës *“Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatin për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019”*, duke i dhënë fjalës relatores, zonjës *Miranda Andoni*.

**Miranda Andoni** merr fjalën: Relacioni i është vënë në dispozicion të gjithë anëtarëve dhe të ftuarve për kandidatin Altin Binaj. Në këtë rast kemi të bëjmë me një kandidat që ushtron detyrën e prokurorit. Ai njëherësh është subjekt i vlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Si në çdo rast edhe në këtë rast janë kryer procedurat standard në lidhje me thirrjen dhe pajisjen me formularë. Është njoftuar kandidati për tërheqjen e formularëve dhe autorizimeve përkatëse. Duke qenë se kandidati Altin Binaj është prokuror, ai është subjekt i vlerësimit kalimtar dhe për sa i përket vlerësimit dhe kontrollit të pasurisë dhe të figurës referuar pikës 101 të vendimit nr. 4, pikës 105 të vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionin vakant në Gjykatën Kushtetuese”*, Kandidati magjistrat dhe subjektet e tjera që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84\2016 dhe që janë konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar nga organet e rivlerësimit, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit. Në rastin tonë kandidati Altin Binaj, me vendimin nr. 101, datë 23.01.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është konfirmuar në detyrë, me detyrën e prokurorit dhe drejtues pranë Prokurorisë së Apelit Vlorë. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 12.03.2019. Kjo e vërtetuar me shkresën e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, datë 27.08.2020. Pavarësisht se kandidatët nuk i nënshtrohen verifikimit të pasurisë, në pikën 109 të vendimit nr. 4 të KED-së, duhet të kemi parasysh se është përcaktuar afati 180-ditor lidhur me kryerjen e procedurës të verifikimit dhe kontrollit të plotë të pasurisë, sipas ligjit 84/2016 llogaritet nga dita e dorëzimit të Deklaratës së pasurisë pranë ILDKPI. Gjithashtu në pikën 110 (citohet neni) dhe konkretisht sipas pikës 110 të vendimit nr. 4, thuhet citon *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit*



*të Lartë të Drejtësisë” thuhet se ; nëse procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidatëve magistratë dhe subjekteve të tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit 84/2016, fillojnë pas afatit 180 ditor të përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1 të ligjit nr. 9049/2003 procedura e verifikimit të pasurisë së këtyre kandidatëve shtrihet mbi interesat pasurore, private dhe konfliktin e interesit, për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e tyre ne detyrë. Nga ILDKPI, kontrolli është ushtruar për periudhën pas datës së dorëzimit të deklaratës së Rivlerësimit, Vetting deri në datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatit për anëtar në Gjykatën Kushtetuese dhe konkretisht për periudhën 31.1.2017 deri në 30.01.2020.*

**Relatorja Miranda Andoni** vijon më pas me relatimin e relacionit për kandidatin Altin Binaj.

**Vitore Tusha** fton anëtarët të vijnë me pyetjet, komentet dhe diskutimet.

**Anëtarët** nuk kanë pyetje dhe komente.

**Erinda Ballanca** merr fjalën duke vënë në dukje disa gabime të vogla që duhet të korrigjohen dhe pyet: “Në pikën 18 të relacionit ju prezantoni se për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë të kandidatit Altin Binaj, Këshilli në mënyrën e vetë ka dërguar shkresa disa organeve. Të tëra organet janë organe financiare. Nuk shoh në pikën “ç”, ka Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Tatimeve, Ministria e Drejtësisë, OSHE dhe QKB. Verifikimi është bërë vetëm për aktet, vetëm për pasuritë e luajtshme, apo edhe për pasuritë e paluajtshme?”

**Miranda Andoni** sqaron se verifikimi kryet për pasurinë në tërësi, duke respektuar dhe kërkesat e këtij ligji, për vlerën, për të cilën ai ka dhe detyrimin të deklarojë. Pasuria e paluajtshme detyrimisht.

**Erinda Ballanca** e rimerr fjalën, duke shprehur edhe një shqetësim tjetër që i ka lindur për shkak të dokumentit. “Kopjen e deklaratës së pasurive e administron Këshilli? Ne nuk e kemi te dokumentet që na janë bashkëngjitur, sepse unë i kam parë të tëra nga fillimi deri në fund. Kopje të deklaratës e furnizon Këshilli, ia jep Këshilli kandidatit siç ka ndodhur edhe vitin e kaluar dhe kandidati e dorëzon në ILDKPI. ILDKPI-ja kur sjell në Këshill përgjigjen, a sjell dhe një kopje të deklaratës apo jo? Në dokumentet që ne kemi, të paktën sipas listës që na është bashkëlidhur, kopje të deklaratës ne nuk kemi. Ndoshta mund të jetë në dosje dhe nuk është paraqitur te ne për një arsye apo për një arsye tjetër, nuk ka rëndësi. Ne kemi një kopje të raportit të ILDKPI-së, por deklaratën jo. Sepse deklarata ka të dhëna të

tjera, të cilat kanë të bëjnë më tej me punën e verifikimit që vetë ky Këshill do të bëjë përtej raportit të ILDKPI-së. Nëse KED-ja dhe ky ka qenë një diskutim që e kemi bërë, nëse KED-ja do të bëjë një rivefikim vetë të gjetjeve të ILDKPI-së, apo jo? Ky do të ishte përfundimi dhe për sa kohë që ne nuk kemi kopje të deklaratës, mendoj se nuk ka si të bëhet verifikimi i punës së ILDKPI-së për kandidatin përkatës, vetëm nëpërmjet marrjeve të përgjigjeve konfirmuese nga organet financiare apo organet e tjera. Pa diskutim që për kandidatin konkret është procedurë më e shkurtër, sepse ai e ka kaluar dhe është më e thjeshtë situata, pasi e ka kaluar Vettingun, por doja të dija këtë aspekt për efekt të procedurës që Këshilli kryen në rastin konkret.”.

**Miranda Andoni** sqaron: “Unë personalisht nuk kam vënë re ndonjë ndryshim përsa i përket verifikimit të pasurisë, sepse nëse do të krijohen dyshime të mospërputhjes midis deklaratës dhe akteve mbështetëse, mund të relatohej dhe mund të përbënte shkak për të hetuar vetë Këshilli. Unë vetë, me aq sa kam parë, nuk konstatoj ndonjë mospërputhje midis pasurisë dhe burimit të kësaj pasurie. Në fakt, ka shtesë të pasurisë pas deklaratës. Por, edhe hetimi nga ILDKPI-ja pikërisht për këtë periudhë është bërë ,nga 31.01.2017 deri më 31.01.2020 dhe prej tyre është analizuar, në fakt , edhe pasurinë edhe burimet e kësaj pasurie. Dhe unë vetë, nga ana ime. nuk konstatoj ndonjë mospërputhje, sepse do të isha edhe unë e detyruar t’jua sugjeroja dhe të përbënte shkak për të hetuar.”.

**Erinda Ballanca** pyet përsëri nëse deklarata tek KED-ja, deklarata e subjektit, vjen mbrapsht. Ndoshta duhet të pyesni këshilltarët. Formulari i plotësuar, se te neve nuk ka ardhur. Te dokumentet tona që ne kemi, nuk ka ardhur. Mund të jetë gabim, mund të jetë mirë, nuk e di, ne kemi mungesë. Unë po pyes: a ka një kopje të deklaratës?

**Miranda Andoni** sqaron se duhej të kishte ardhur, por për shkak të punës shumë voluminoze, mund të jetë kjo ndonjë arsye, që nuk është vënë në dispozicion. Gjithsesi vë në dukje se do të kthejë një përgjigje të saktë.

**Erinda Ballanca** thotë se rëndësi ka që të jetë.

**Vitore Tusha** merr fjalën për të sqaruar se si Këshilli, për të lehtësuar këtë procedurë, që në fund të muajit korrik, mbi kërkesën e zonjës Ballanca, Avokatit të Popullit, i janë vënë në dispozicion për studim, materialet që kanë më tepër volum të të gjithë kandidatëve.

**Saida Dollani** merr fjalën duke thënë se këtë situatë e ka sqaruar vetë ligji nr. 115/2016 në nenin 235 pika 1, citon dispozitën ligjore, dhe shton se, menjëherë pas dërgimit të listave me emrat e kandidatëve ose të paraqitjes së shprehjes së interesit nga kandidatët, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i pajis kandidatët me formularët për deklarimin e pasurive dhe të interesave financiarë. Duke iu referuar pikës 2 të së njëjtës dispozitë ligjore, thekson

de jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularëve për deklarimin e pasurive dhe të interesave financiarë, kandidatët i dorëzojnë ato të plotësuara pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili kryen kontrollin e saktësisë dhe të vërtetësisë së deklarimit brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij. Ndërsa duke iu referuar pikës 3 të së njëjtës dispozitë ligjore, thekson se, kjo dispozitë e sqaron situatën kur parashikon që Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave i dërgon menjëherë Këshillit rezultatet e kontrollit dhe jo formularët të cilët i arshivon në Inspektoriat.

**Erinda Ballanca** merr fjalën: “Në qoftë se ne nuk kemi deklarimin, çfarë verifikohet? Diskutimi është se ky Këshill bën një procedurë verifikimi, themi ne, në qoftë se është vendosur gabim hajde ta ndryshojmë, Këshilli ka vendosur që do të bëj gjithsesi, nuk do të mbetet vetëm peng i rezultatit të ILDKPI-së dhe nëse kjo është e vërtetë, kjo gjë duhet të ketë dhe kopjen e saj, e deklarimit besoj unë. Rezultatet duhet të vijnë bashkë me deklarimin, sepse p.sh. unë kam disa pyetje, jo për këtë kandidat, por për hir të së vërtetës kam për kandidatit tjetër që do të shqyrtohet dhe që nuk janë pyetje të vogla, të cilat, në qoftë se nuk është ajo deklarata, nuk kemi sesi ti gjejmë dhe do ta provojmë me pyetjet që kam për efekt të kandidatit tjetër. Pra, kjo është çështja, prandaj bëra pyetjen. Unë e kërkova formularin, formulari nuk ishte tek dokumentat e dërguara. Këtë herë për hir të së vërtetës ka ardhur edhe një listë me dokumentet goxha më e sqaruar se sa më përpara. Vitin e kaluar nuk ka pasur një listim, e kemi diskutuar disa herë çështjen e dokumenteve që na vinin, për më tepër për të kuptuar se cilat na kishin ardhur dhe cilat jo, jo për ndonjë merak, por për të parë nëse flisnim apo jo të gjithë mbi bazën e të njëjtave dokumente. Dhe nuk ka asnjë kopje të deklaratës, kjo ishte, dhe mbi këtë bazë ishte edhe pyetja që në na lindi. Në se ky verifikim kryhet realisht dhe nëse ne duhet bërë verifikimi për sa kohë që është dërguar gjithë kjo korrespondencë, janë bërë gjithë këto shkresa, është bërë gjithë kjo punë.”

**Miranda Andoni** merr fjalën: “Ndërkohë, një pjesë e mirë e akteve që janë depozituar pranë ILDKPI-së janë pikërisht aktet që i kemi edhe ne këtu në dosjen tonë. Dhe janë të njëjta. Ndoshta nuk mund të jenë të gjitha për këtë nuk mund të them të saktë do të duhet t’i verifikojmë edhe njëherë”.

**Vitore Tusha** pyet nëse ka pyetje, diskutime, komente të tjera.

**Erinda Ballanca** merr fjalën: “Në lidhje me raportimin që është bërë, arsye që po e shpreh është pikërisht qëndrimi që ka mbajtur Avokati i Popullit në lidhje pikërisht me ndihmën administrative që Avokati i Popullit i kërkon DSIK-së, por kjo është një çështje që e kemi ngritur në raportin tonë vjetor, është e përsëritur por meqenëse është dhe sekretari i

komisionit të ligjeve në Kuvend, unë gjej rastin ta ngre si problem që duhen të bëhen amendamentet ligjore që Këshilli të ketë informacion të drejtpërdrejtë nga organet ligjzbatuese siç parashikon ligji duke e rregulluar këtë edhe me varësitë përkatëse të tyre. Pse e them këtë, sepse nuk mund që informacioni që i vjen Këshillit të jetë i filtruar nëpërmjet një Agjencie e cila nuk është e pavarur, por është nën funksionin e ekzekutimit dhe në këto kushte nuk plotësohen në gjykimin tim parashikimi apo vullneti që ka pasur legjislatori, qoftë në Kushtetutë, qoftë dhe në ligj, për të pasur një pavarësi tërësisht të garantuar të këtij organi në mbledhjen e informacioneve. Sepse aty është thënë që mund t'i drejtoheni këtyre organeve për të marrë informacion. Ata (DSIK) thonë që në ligjin tonë nuk është për detyrë që ti japim informacion KED-së. Këtë po relatoj për shkak të problematikës së vitit të kaluar dhe meqenëse kjo ka qenë një gjetje e raportit tonë dhe meqë është dhe sekretari i komisionit të ligjeve, doja ta sillja përsëri në vëmendje”.

**Vitore Tusha** shprehet se këtë gjetje e keni prezantuar edhe më parë dhe vuri në dukje: “Në rastin e kandidaturës konkrete, ju si Avokat Populli, keni ndonjë informacion? Pyetjen e bëj, sepse ne i jemi drejtuar edhe institucioneve të tjera. Gjithsesi, kushdo që është i angazhuar me këtë çështje, mund të kontribuoj në këtë drejtim. Prandaj ju pyes drejtpërsëdrejti nëse keni diçka, qoftë edhe të tërthortë në këtë drejtim?”

**Erinda Ballanca** merr fjalën: “Jo, nuk kemi as edhe një informacion. Ishte vetëm në nivel parimor, e thashë arsyen pse, duke qenë se vijon kjo çështje përsëri, kjo problematikë. Jam e kënaqur që më në fund kanë ardhur certifikatat e sigurisë për anëtarët e Këshillit, pasi është një çështje shumë e rëndësishme. Duhet të kishte qenë më mirë të kishin ardhur më përpara për ta adresuar dhe për ta çuar çështjen përpara por e them, e thashë për atë shkak, e bëra të qartë arsyen pse. Kjo ka qenë një zgjidhje që Këshilli është përpjekur për t'i dhënë, për ta çuar procesin përpara.”.

**Vitore Tusha** merr fjalën dhe propozon që të bëhet një pushim që diktohet nga kushtet teknike të regjistrimit të mbledhjes.

### **Rifillon mbledhja.**

**Vitore Tusha** ia jep fjalën relatores për “*Shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatin për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019*”, zotin *Artan Spahiu*.

Relatorja vazhdon me relatimin e kandidatit që vjen në radhë sipas rendit të ditës, Artan Spahiu. Dhe për këtë kandidat janë vënë në dispozicion aktet, pjesë e dosjes, ju janë përcjellë me *e-mail* anëtarëve.

**Vitore Tusha** pyet anëtarët nëse ka pyetje, diskutime ose komente.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje.

**Erinda Ballanca** merr fjalën: “Unë i kam edhe me shkrim të përmbledhura, do t’ia u dërgoj edhe me *e-mail*, dhe në fakt në këtë rast kam disa, jo pak pyetje apo pikëpyetje, përveç atyre të ngritura nga ana e relatores, për sa i përket faktit të vjetërsisë, apo nëse plotëson apo jo kriteret e ligjit për sa i përket vjetërsisë.

Pyetjet e para që unë kam ose çështjet e para që unë kam mund të bëhen me raportin e ILDKPI-së. Raporti i ILDKPI-së ka nxjerrë personin si një individ, i cili është në përputhje me parashikimet, domethënë nuk është në konflikt interesi, ka kryer deklarin të saktë, nuk ka deklarin të rremë, nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit. Nga një fakt që ne në mënyrë krejtësisht rastësore jemi në dijeni, unë ashtu sikurse të gjithë ju, kemi marrë në muajin janar të këtij viti (viti 2020), një shkresë të firmosur nga Komisioni i Monitorimit të Reformës në Drejtësi pranë Kuvendit, me firmë e këtij zotërie, në të cilën i kërkon KED, ndërkohë që ishte kandidat që kishte aplikuar dhe priste për t’u vlerësuar nga ana e KED-së, ka bërë 2 veprime, ka marrë një vendim sesi duhet Këshilli të veprojë në lidhje me funksionimin e tij dhe së dyti ka bërë dhe raportin vjetor të punës së KED-së. Pra mbikëqyrjen për veprimtarinë e KED-së 2019. Pra, janë 2 akte në të cilat ky individ, pavarësisht se ka qenë kandidat (kandidatura e tij nga aktet rezulton që është në dhjetor të vitit 2019, menjëherë mbasi janë bërë shpalljet), ka qenë edhe në monitorimin e hedhjes së shortit për KED-në dhe nuk e di në atë datë ka qenë apo jo kandidat për t’u përzgjedhur në Gjykatën Kushtetuese, por më tej unë kam 2 shkresa, të cilat do t’ju vë në dispozicion, në të cilat zotëria rezulton që ka marrë disa vendime, ka qenë pjesëmarrës në disa vendime, të cilat kanë të bëjnë me aktivitetin e organit të KED. Unë mendoj se kjo është një çështje të cilën Këshilli duhet ta sjellë në vëmendje për ta parë qëndrim e tij si kandidaturë. Ndoshta mund të mos vlerësohet por duhet të trajtohet, ndoshta ai e ka shprehur në Komision kur ka marrë pjesë dhe anëtarët kanë thënë: “Jo, vijo”. Dua që për efekt, qoftë të transparencës, qoftë të garantimit ose të verifikimit të këtij fakti, ndoshta do të duhet një hetim pak më i thellë në lidhje me këtë çështje. Të paktën për këto 2 momente: pra, pse e them këtë gjë dhe e bëj me dije se është vendimi nr. 26 i 2019, këtë duhet ta kuptojmë, ka firmosur dhe zotëria në datën, 20.12.2019. Të miratoj raportin mbi monitorimin e procesit të zgjedhjes të anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili do të ushtrojë detyrën për vitin 2020. Ka qenë

kandidat, ka firmosur si kryetar, përveçse ka përcjell vendimin nr. 26, vendim i cili i është përcjellë KED-së dhe unë e kam gjithashtu është edhe raporti mbi monitorimin e procesit të zgjedhjes së anëtarëve, pra ka qenë në monitorim, ka firmosur edhe raportin.

**Bledar Dervishaj** merr fjalën: “Ka zgjedhur edhe një prej goglave në shortin e zhvilluar. Po, edhe një gogël. Ndoshta atë ditë mund të mos ketë qenë...”.

**Erinda Ballanca** vazhdon: “Vendimi nr. 26 i 2020 i datës 14.01.2020 “Për miratimin e raportit mbi disa rekomandime përpara konstituimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që do të funksionojë përgjatë vitit 2020”. Gjithashtu dhe kjo rezulton të jetë firmosur nga kryetari Artan Spahiu dhe nga anëtarët e tjerë. Ky vendim i ka ardhur Këshillit ndërkohë që ai ka qenë vetë person për t’u vlerësuar si kandidat, nga ana e Këshilli, vendimi i ka ardhur Këshillit ose është pretenduar prej tij se mund të kishte një vendimmarrje në lidhje me mënyrën sesi Këshilli do të konsideronte anëtarësinë apo konstituimin e tij. Kështu që, unë mendoj se kjo është një çështje për sa i përket aspektit të konfliktit të interesit, e cila duhet verifikuar. Gjithashtu, për periudhën, nga raporti i ILDKPI-së dhe nga CV-ja e personit, rezulton se ai në kohën kur ka qenë jurist, pretendon i lartë në Këshillin e Qarkut, ka qenë edhe jurist *part-time* në 4-5 komuna, po brenda të njëjtit juridiksion. Është një person, i cili është disa herë i punësuar. Nuk ka ndonjë gjë të keqe se mund të jetë shumë i zoti, por është një çështje e cila ndoshta duhet verifikuar pak më tepër për sa i përket konfliktit të interesit. Sepse ky individ rezulton bashkë me të shoqen që kanë pasur në çdo kohë nga 2 ose 3 punë *part-time* në administratën shtetërore së bashku me një punë full-time po në administratën shtetërore. Mund të qëlloj që mund të jetë individ perfekt dhe njeriu më i zoti i mundshëm. Nuk kam asnjë problem, por unë nuk e kam ndeshur deri më tash, në eksperiencën time kur kam qenë privat, por edhe në eksperiencën time nuk kam parë që të kemi “superman” që përveç punës *full time* të bëjnë 3 punë minimalisht në të njëjtën kohë *part-time*, po në administratë shtetërore. Mund ta bëjë një privat, dypunësim, trepunësim brenda administratës. Ndoshta duhet verifikuar, nuk e di! Ndoshta është e saktë, ndoshta nuk ka pasur konflikt interesi?! Por duke qenë për një periudhë të caktuar kohë audit...”.

**Miranda Andoni** sqaron se po merren me gjetjet, vlerësimet i bëjmë më vonë.

**Erinda Ballanca** merr fjalën: “Në gjykimin tim duhet të verifikohet. Kalojmë te relacioni, nuk e di ndoshta nuk është vënë re, në mënyrë të plotë ose ndoshta nuk është vlerësuar në këtë mënyrë por edhe në CV zotëria vazhdon të deklarojë që sot e kësaj dite është këshilltar juridik *part-time* i një Kryetari Bashkie. Përveç të qenit *full time* pedagog apo zëvendësrektor është edhe këshilltar juridik i jashtëm i kryetarit të bashkisë. Këshilltarët konsiderohen pjesë e stafit politik. Ne kemi bërë një debat të madh në këtë këshill në lidhje

me të qenit apo jo si funksione politike. Ndoshta duhet verifikuar. Dhe vazhdon ta ketë dhe sot, dhe jo para 10 vjetëve. Edhe sot që flasim, është këshilltar juridik i jashtëm i kryetarit të bashkisë. Mund të ketë vend për të bërë një interpretim në lidhje me faktin nëse bashkitë konsiderohen apo jo pjesë e administratës publike, por kjo është çështje tjetër. Këshilli i qarkut qartësisht është, por duhet verifikuar edhe fakti nëse ky person ka vepruar në përputhje me ligjin, sepse ka një vendim të Këshillit të Ministrave, i cili qartësisht thotë se i vetmi organ që mund të ketë këshilltar të jashtëm është Kryetari i Këshillit të Ministrave. Pra, as Avokati i Popullit, askush nuk mund të ketë këshilltar të jashtëm, se të gjithë këshilltarët duhet të jenë njerëz që punojnë *full time*. Këshilltarët e jashtëm duhet të jenë të përjashtuar. Përjashtimisht VKM-ja përkatëse e cila e trajton thotë, që këshilltar të jashtëm mundet të ketë vetëm Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Një kopje të VKM-së ua bashkëlidh gjithashtu. Kjo ka të bëjë me faktin se a plotëson apo jo këtë kriter? Ndoshta ne do të duhet të shikojmë pak më thellë apo të verifikojmë pak më thellë. Të pyesim kandidatin, se ai mund të ketë një interpretim të vetin që duhet ta japë, por ndoshta ka vend për të bërë një verifikim pak më të thellë. Gjithashtu, në lidhje me çështjen e kriterit të pasurisë, unë kam vënë re nga një verifikim imi shumë i thjeshtë, ndoshta jo shumë i hollësishëm. Unë kam vënë re që në të dyja kontratat e shitblerjes së pasurive të paluajtshme të bëra në vitin 2013, pra dhe shitjen e një apartamenti të mëpasshëm që ka pasur, dhe blerjen e një apartamenti te ri, në kontratë thuhet që pagesa është bërë jashtë zyrës së noterisë. Vlerat janë të larta. Njëra është 6 milionë tjetra 7 milionë e 900 mijë. Tek të dyja, këto janë vlera të cilat në vitin 2013 nuk mund të kalonin ose jo në sistemin bankar. Nuk e di, kontrata nuk thotë nëse është bërë pagesa me bankë apo jo, apo është bërë pagesa kesh. Justifikimi gjendet, ndoshta duhet të hetojmë. Të verifikojmë dhe të hetojmë edhe në lidhje me këtë çështje. Midis diferencës rezulton se apartamenti që zotëria ka shitur ka qenë në vlerën e 6 milionë lekëve me sipërfaqe 106 m2. Është një apartament që ai e ka shitur më shtrenjtë dhe apartamentet që ka ai blerë, i ka blerë më lirë. Ndoshta duhet parë, duhet verifikuar për m2. Duhet parë ndoshta çështja e verifikimit të çmimit të tregut apo të ndonjë çmimi preferencial për shkak të detyrës që ai ka pasur si person i lidhur me kryetarin e Bashkisë dhe me të gjithë veprimtarinë që kryetari i bashkisë mund të ketë. Mund të jetë, mund të mos jetë, nuk e di. Ndoshta duhet bërë një verifikim, nuk them “apriori”, kjo gjë ekziston, por ndoshta do të duhet të kishte një hetim pak më të thellë. Në gjykimin tim, unë këtë çështje e kam diskutuar edhe vitin e kaluar. E di që KPK-ja ka qëndrim tjetër, por ka qenë një qëndrim imi parimor, të cilën e kam ngritur në rastin e kandidatës Zhaklina Peto. Po ta kujtojmë, shpenzimet e llogaritura për të, kur bëhet llogaria e minusit dhe plusit për atë kandidat, ashtu sikurse edhe shpenzimet e

Ilogaritura për këtë kandidat, i cili rezulton në një gjendje familjare prej 5 personash, të paktën nga sa unë e shikoj, janë llogaritur në kushtet e nivelit minimal. Pra, është llogaritur me vlerën minimale të shpenzimeve. Unë mendoj që do të ishte me interes dhe për hir të transparencës që ne individit t'i thoshim: i nderuar zotëri juve keni jetuar me standardin minimal, dhe secili prej nesh mund të ketë një standard tjetër. Unë, për shembull, nuk kam jetuar asnjëherë ngushtë, kam pasur një standard tjetër. Për mua është e pamendueshme që në një familje 5 personash, plus shpenzimet mujore që ka deklaruar zotëria të jenë 750 mijë lekë për të gjithë familjen. Duke përfshirë, ujin, dritat, qiraja, blerje pajisjesh, blerje veshjesh, blerje te mobilimit, sepse në të dyja rastet unë nuk kam parë deklaratën. Prandaj doja ta pyesja sepse në të dyja rastet personi nuk ka deklaruar vlerë mobilimi. As në rastin e parë, as në rastin e dytë, as në apartamentin që ai ka blerë në vlerën e 7 milionë e 900 mijë lekëve. Ka blerë 1 apartament, 2 apartamente që në total shkojnë në 160 e ca m2 dhe nuk ka vlerë mobilimi për efekt të llogaritjes së këtyre shpenzimeve. Ndoshta duhet pyetur dhe duhet sqaruar. Ndoshta ka njerëz që mund të thonë jo, unë nuk kam jetuar në nivelin minimal, unë kam jetuar në nivel më të lartë. Atëherë ai duhet të na deklarojë se sa kanë qenë shpenzimet e tij ndër vite. Pra, nuk del me një nivel të ulët kursimi, del me një nivel të lartë për të ardhurat e nivelit që ai ka deklaruar, me gjithë këto 2 punësimet, 3 punësimet, 4 punësimet dhe përsëri del me një vlerë jo të vogël të kursimit, pasi ka 10 milionë lekë të reja gjendje kesh, dhe një apartament të mbajtur në këtë vit, që nga viti 2004 dhe deri tani. Domethënë që i ka realizuar. Me të njëjtat të ardhura ose me të ardhura pak më të vogla nga viti '99 deri në vitin 2004 nuk ka deklaruar asnjë pasuri, sepse sipas raportit të ILDKPI-së ai ka qenë subjekt deklarues në vitin 2004 apo 2003. Në vitin 2004 ka deklaruar që nuk ka pasur asnjë kursim dhe asnjë pasuri që nga '99 deri në 2004-ën, pra për 5 vjet. Dhe rezulton që gjithë të tjerat i ka realizuar nga viti 2004 që është bërë ai deklarim deri në vitin 2020. Në llogaritjen e bërë nga ILDKPI-ja rezulton se zotëria ka bërë edhe punën e avokatit përveç punës së të qenit pedagog në fakultet dhe jurist në vende të ndryshme pune, pra, gjithsesi ka bërë edhe punën e avokatit. Nga raporti i ILDKPI-së, po ngre një pyetje, sepse aty nuk citohet vlerat e faturave të lëshuara nga subjekti për 3 vjet është kaq dhe ajo është llogaritur e gjitha si vlerë fitimi, në fakt diferenca ekziston. Po të shikojmë raportin që ILDKPI-ja ka bërë për zotin Binaj, thuhet fitimi i realizuar nga bashkëshortja në punët si avokate dhe thuhet fitimi. Është një fitim i deklaruar i cili është edhe i kryqëzuar me të ardhurat nga tatimet. Për rastin konkret, për zotërinë në fjalë është vetëm vlera e faturave të lëshuara që do të thotë të ardhurat për biznesin e tij të avokatisë. Nga ana tjetër, çdo biznes ka dhe shpenzime. Nuk duket që të jetë llogaritur ndonjë vlerë për sa u përket shpenzimeve dhe ndonjë vlere për sa i përket fitimit që



zotëria ka pasur. Ndoshta ILDKPI-ja i ka bërë këto pyetje në raportin e vet. Nuk rezultojnë, pra, në atë raportin që unë kam lexuar të ILDKPI-së. Them të gjitha këto sepse diferenca apo rezultati mbi bazën e të cilit është deklaruar se ka pasur burime të mjaftueshme financiare për të krijuar pasuritë që ka krijuar është shumë e vogël. Është jashtëzakonisht shumë e vogël midis kësaj, pra është një vlerë e cila në 15 vjet është lehtësisht e ndryshueshme nëse këto 2 rezultate, këto diskutime që unë ju thashë janë të vërteta. Ose nuk them se janë të pavërteta këto që po deklaroj, d.m.th, rezultati në përfundim nuk do të ishte një rezultat i cili do t'i jepte drejtë kandidatit, por mund të ishte një rezultat i cili mund t'i jepte jetë pikëpyetjeve që unë kisha. Që do të thotë do të mjaftonte një pushim në vite të kishte bërë kjo familje për ta ndryshuar këtë balancë. Ndoshta s'kanë bërë, prandaj them. Mund të jetë e vërtetë që nuk mund të kenë bërë, nuk është e thënë, ka njerëz që nuk e kanë bërë. Këto janë pyetjet, çështjet që unë i nxora nga dosja e ILDKPI-se. Dosjen që e keni juve e kam dhe unë, por nuk kam parë atë formularin e deklarimit. Këtë e them se ndoshta zotëria te formulari i deklarimit ka deklaruar që kam bërë shpenzime të tjera, domethënë më shume se mund të ketë. Prandaj ju pyeta edhe për shpenzimet e mobilimit. Unë kam bërë një verifikim, për hir të së vërtetës dhe kam verifikuar nëse llogariten në shpenzimet e shportës dhe në cilin pikë jemi, sepse diferenca është shumë e vogël. Në qoftë se ne na ikin të themi, bëhet diferenca midis të ardhurave dhe jo fitimit për pozicionin e tij si avokat, mund të ndryshojë balanca. Pra, mua vetë më duket me pikëpyetje fakti që një familje me 5 persona të mundet të jetojë qofte edhe në Elbasan me atë vlerë të ardhurash. Duket shumë e vështirë, personalisht.

**Vitore Tusha** fton relatoren të vijojë me kandidaturën e zotit Dedë Kasneci.

**Miranda Andoni** lexon relacionin lidhur me kandidaturën e zotit Dedë Kasneci: “Në lidhje me përllogaritjen e punës me kohë të pjesshme si periudhe e vjetërsisë në pune, kandidati ka speguar se është në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Republikës së Shqipërisë, me të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë dhe Legjislacionin e brendshëm të Republikës së Shqipërisë, i përafuar plotësisht me legjislacionin përkatës të BE-së lidhur me punën me kohë të pjesshme”.

**Fatjona Memçaj** thotë se i kanë përpara dhe i kanë lexuar.

**Miranda Andoni** sqaron se relacioni i mëparshëm ishte nga këshilli i mëparshëm dhe vazhdon me leximin e relacionit lidhur me kandidaturën e z. Dedë Kasneci. Në përfundim relacioni i përpiluar i është prezantuar zv/Kryetares, është proceduar me njoftimin për mbledhje. I është njoftuar kandidatit procedura e ndjekur dhe është e pasqyruar brenda këtij relacioni. Këto janë gjetjet. Duhet thënë se për këtë kandidat ka disa vendime të cilat janë: vendimi nr. 58, 59, 60, datë 24.07.2019 të KED-së; vendimet nr.12 dhe nr.13, datë

17.07.2020 të KED-së, ku janë trajtuar këto gjetje dhe më përpara. Janë trajtuar edhe herë të tjera për vakancat e tjera.

**Vitore Tusha** pyet anëtarët nëse kanë pyetje, sqarime ose komente.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje dhe komente.

**Erinda Ballanca** sqaron se ky është një rast i trajtuar dhe nuk ka pyetje.

**Vitore Tusha** vijon me kandidaturën e zotit Gentian Mete.

**Miranda Andoni** merr fjalën: “Kandidatura e zoti Gentian Mete. Në këtë rast kandidati ka dhënë dorëheqjen. Si për çdo rast edhe për këtë kandidaturë janë zbatuar procedurat standarde, ka shprehur interesin për vendin vakant. Në datën 21.01.2020 kandidati është paraqitur para KED-së, është pajisur me formularin e deklarimit dhe autorizimit në datën 04.02.2020 ku ka njoftuar këshillin se ka vendosur të tërhiqet nga kandidimi për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese. Shkresa është e depozituar pranë këshillit në datën 04.02.2020.”

**Vitore Tusha** pyet nëse ka pyetje ose diskutime.

**Erinda Ballanca** thotë se në të gjitha rastet e tjera është dhënë një kopje e shkresës për dorëheqjen.

**Miranda Andoni** prezanton të gjithë përmbajtjen e shkresës dhe sqaron: “Në lidhje me kandidatin Gentian Mete është shkresa njoftim me lëndën mbi dorëheqjen për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese drejtuar KED-së. Shkresa është depozituar në datën 04.02.2020 me këtë përmbajtje: “Unë i nënshkruari Gentian Mete për arsye personale dhe familjare njoftoj dorëheqjen time nga kandidatura për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese bazuar në dekretin nr.113164 viti 27.11.2019 për plotësimin e vakancës së parakohshme të krijuar për vendin vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Duke ju falënderuar për mirëkuptimin i uroj suksese secilit nga kandidatët e tjerë”. Është nënshkruar nga vetë kandidati. Tiranë, më 04.02.2020.

**Erinda Ballanca** rimerr fjalën: “Pra ka të bëjë me mënyrën e shprehjes së vullnetit dhe për mua rezulton që vullneti i tij është i qartë. Në dokument ka vetëm një sigël të firmosur, emri është i printuar, por ne prezumojmë që, për sa kohë nuk ka pasur interesim nga ky kandidat deri tani për vijueshmërinë e ndonjë procedure tjetër, ne prezumojmë se është e qartë. Relacioni i është njoftuar apo jo?”

**Vitore Tusha** shprehet se me të njëjtën procedurë, në të njëjtën datë, në datën 10 janë njoftuar të gjithë kandidatët, anëtarët dhe të ftuarit.

**Miranda Andoni** shprehet se në dosje gjendet edhe komunikimi.

**Vitore Tusha** shprehet se, përfundoi shqyrtimi i gjetjeve për të gjithë kandidatët që ishin caktuar në pikën 2 të rendit të ditës.

**Këshilli** vijon me pikën 3 të rendit të ditës që lidhet me vlerësimin e njoftimit të organeve të emërtesës; Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Shqipërisë për rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese vakancë e parakohshme.

**Vitore Tusha** prezanton rrethanat për të cilat është vendosur në rendin e ditës kjo çështje : “Siç jeni në dijeni ky Këshill ka objekt shqyrtimi 3 vakanca për momentin, të cilat kronologjikisht janë: Vakancë e shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe po i referohemi datës së rishpalljes, datë 21.08.2019. Vakancat, e shpallur nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë në datë 27.09.2019 dhe ajo e shpallur në 22.11.2019, e cila do të fillojë të shqyrtohet ditën e sotme. Në lidhje me dy vakancat e para Këshilli ka zhvilluar mbledhjet e datës 17.07.2020, në të cilën janë shqyrtuar shumica e kandidatëve, si dhe atë të datës 17.08.2020 për kandidatin magjistrat. Po ju përmend disa fakte që gjithsesi të gjithë jeni në dijeni, duke qenë se keni qenë prezent në mbledhjet e Këshillit. Konkretisht, në mbledhjen e datës 17.07.2020 kemi shqyrtuar dhe verifikuar ato kandidatë, relacionet e të cilëve ishin gati, pa përfshirë vetëm kandidaten magjistrate zj. Panajoti, e cila u shqyrtua në datën 17.08.2020. Në lidhje me kandidatët që kanë aplikuar në vakancën e rishpallur nga Kuvendi në datë 21.08.2019, në mbledhjen e datës 17.07.2020 është vendosur ndalimi i kandidimit për Ardita Resula Buna, Dedë Kasneci, Vjosa Dodo dhe Shaqir Hasanaj, ndërsa për kandidatin Klodian Radon është vendosur përfundimi i procedurës së verifikimit të tij. Në lidhje me kandidatët që kanë aplikuar në vakancën e rishpallur nga Presidenti në datë 27.09.2019, në mbledhjen e datës 17.07.2020 është vendosur ndalimi i kandidimit për Besnik Muçi, Dedë Kasneci, Shaqir Hasanaj, Vasil Bendo dhe Vjosa Dodo. Ndërsa për kandidatët Prelë Martini dhe Envi Hicka është vendosur për përfundimi i procedurës së verifikimit të tyre. Të gjitha vendimet e tyre janë të arsyetuara shumë shpejt dhe konkretisht për Envi Hickën, Prel Martini, Klodian Rado dhe Besnik Muçi në datë 22.07.2020. Për Vjosa Bodon të dyja vendimet që i përkasin respektivisht vakancës së Presidentit dhe të Kuvendit janë zbardhur në datën 27.07.2020 dhe në datën 28.07.2020. Për Ardita Bunën vendimi është zbardhur më datë 27.07.2020, për Dedë Kasnecin të dyja vendimet janë zbardhur më datë 28.07.2020, për Shaqir Hasanaj të dyja vendimet janë zbardhur më datë 28.07.2020. Po ashtu dhe për Vasil Bendon vendimi është zbardhur më datë 28.07.2020. Janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit brenda afatit ligjor vendimet e kandidatëve Vjosa Bodo,

Ardita Buna dhe Shaqir Hasanaj. Ankimet e kandidatëve Vjosa Bodo dhe Ardita Buna janë rrëzuar, për të cilat jeni në dijeni, pasi ky fakt kjo është bërë prezent dhe në mbledhjen e kaluar, por sot ju paraqes vendimet përkatëse. Ndërsa ankimi i paraqitur nga Shaqir Hasanaj në lidhje me të dyja vendimet e KED-së është pranuar dhe ato janë shfuqizuar me vendimin nr. 67/2020 të Gjykatës Administrative të Apelit. Pas këtij vendimi KED-ja ka thirrur menjëherë mbledhjen për ta rishqyrtuar çështjen sipas procedurës. Në mbledhjen e radhës, të datës 21.08.2020 Këshilli ka vendosur përsëri ndalimin e kandidimit për z. Shaqir Hasanaj. Edhe vendimet e datës 21.08.2020 të KED-së për kandidatin Shaqir Hasanaj, janë ankimuar përsëri nga ky i fundit. Prandaj ai është i vetmi kandidatët që është akoma në proces gjyqësor. Pra, për këtë kandidat vendimet e KED-së nuk kanë marrë formë të prerë, pasi janë ende pa u shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit. Ndërsa vendimi i KED-së për kandidaten zj. Regleta Panajoti i marrë në mbledhjen e datës 17.08.2020 është arsyetuar në datën 27.08.2020 dhe nuk është ankimuar, prandaj është vendim i formës së prerë. Doja t'ju sillja në vëmendje se vendimet u janë komunikuar të gjithë kandidatëve në dy rrugë me e-mail dhe në rrugë postare. E-mail-i ju është komunikuar të gjithëve në adresën që kandidatët kanë komunikuar me Këshillin dhe nuk ka asnjë e-mail të kthyer. Ndërsa nga posta na është kthyer vendimi i kandidatit Dedë Kasneci. Së fundmi, për ta realizuar dhe me postë komunikimin me këtë kandidat, kemi bërë një lajmërim duke iu referuar jo vetëm adresës ku banon, por dhe adresës së institucionit ku ai punon. Komunikimi i vendimeve vërtetohet me dëftesat e komunikimit, që ju janë paraqitur. Në konkluzion, të gjitha vendimet e KED-së kanë marrë formë të prerë, përveç vendimeve nr. 22 dhe 23 që lidhen me kandidatin Shaqir Hasanaj dhe që i përkasin të përkatësisht vakancës së rishpallur nga Kuvendi në datë 21.08.2019 dhe vakancës së rishpallur nga Presidentit në datë 27.09.2019. Kjo është arsyeja përse unë mendova ta përfshij në rendin e ditës këtë çështje, e cila u prezantua që mbledhjen e shkuar nga znj. Dollani. Gjithsesi faktet ju i njihni, nuk dini datat ekzakte, të cilat i prezantova edhe në drejtim të evidentimit të punës së kryer. Ngelet fakti i njohur publik që kemi vetëm vendimet e lartpërmendura të KED-së për një kandidat të cilat janë ankimuar. Këtë shqetësim më përpara e kam ndarë me Avokaten e Popullit, me përfaqësuesen e kryetarit të Kuvendit dhe me disa prej anëtarëve të KED-së. Nëse ka diçka tjetër që ju duhet mund të ma thoni. Mund të vijojmë me diskutimin sipas radhës.

**Fiona Papajorgji** shprehet se çështja që lidhet me njoftimin e organeve të emërtesës, Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Shqipërisë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese vakanca të parakohshme, është diskutuar dhe më parë në KED, nga relatorja znj. Saida

Dollani, në momentin e mbylljes së procedurës e verifikimit për këto dy vakanca, edhe pse potencialisht vendimet e KED-së në atë kohë mund të ankimoheshin. Ajo tha: “Faktikisht, vendimi nr. 4 i KED-së që rregullon procedurën e verifikimit të kandidatëve, në pikat 32 dhe 49, parashikon se kur gjatë zhvillimit të procedurave të verifikimit, për shkak të tërheqjes nga kandidimi apo të vendimit të ndalimit nga kandidimi, numri i kandidatëve, për atë pozicion vakant në Gjykatën Kushtetuese zbrit në më pak se 3 kandidatë, Këshilli mund të vendosë njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për pozicionin vakant të gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese.

Edhe pse pika 49 e vendimit nr. 4, të lartpërmendur, parashikon se ndërkohë Këshilli mund të vendosë pezullimin e procedurës së verifikimit, “pezullimi” i procedurës lihet në diskrecion të Këshillit. Gjithashtu, kjo pikë citon se procedura në fjalë bëhet “në përfundim të bisedimit të çështjes”, çka nënkupton se vendimet e ndalimit të KED-së të kenë marrë formë të prerë, dhe ka qenë pikërisht kjo çështje që ne kemi diskutuar gjithmonë, duke konkluduar se duhej pritur afati 5 ditor i ankimit në Gjykatën Administrative Apelit.

Sot gjendemi përpara një situatë tjetër, ku përveç një vendimi ndalimi të KED-së, të gjithë vendime e tjera kanë marrë formë të prerë. Vlen këtu të theksohet se vendimet e KED-së mund të ankimohen vetëm për shkelje të rënda procedurale. Pra dhe në rastin se vendimi i KED-së do të priset, potencialisht mund të kemi vetëm një kandidat, i cili konkurren për të dyja listat.

Duke qenë se si Kushtetuta ashtu dhe aktet nën ligjore të KED-së kërkojnë hartimin e një liste me një numër prej të paktën 3 kandidatësh nga ana e KED-së, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin se ka përparësi ngritja sa më parë e Gjykatës Kushtetuese, në një bilancim apo ekuilibrim të interesave, edhe pse një vendim ndalimi i KED-së nuk ka marrë formë të prerë, unë mendoj se është rasti të bëhet njoftimi i organeve të emërtesës”.

**Arta Marku** merr fjalën: “U parashtrua në mënyre të hollësishme nga zv.kryetarja e gjithë ecuria dhe procedura e të dyja vakancave dhe që në datën 17.08.2020, kur u bë ndalimi i zj.Panajoti, kemi një numër nën 3. Pra, vetëm një pengësë, që ne të gjithë biem dakord që të veprohet shpejt e që duhen njoftuar organet e emërtesës që të rihapin thirrjen. Ka dhe një pengësë se çfarë do të bëhet me procedurën që ne kemi në vazhdim. Nëse Gjykata Administrative e Apelit do të prishë vendimin si do të veprojmë ne se sipas vendimit nr. 4 në momentin që ne njoftojmë organet e emërtesës për rënien nën 3, ne duhet të pezullojmë procedurën që jemi duke vazhduar, sipas vendimit nr. 4, pika 49. Kështu që këtë duhet të diskutojmë, këtë duhet të zgjidhim. Pra, duhet t’i bëjmë një ndryshim aktit normativ apo ta

kapërcejmë dhe të njoftojmë organet e emërtesës? Tani të gjithë jemi dakord që të njoftohen dhe të veprohet sa me shpejt për rihapje, për rrugëzgjdhje”.

**Miranda Andoni** merr fjalën: “Në rastin konkret jemi në kushtet që janë përfunduar procedura e verifikimit të kandidatëve duke përjashtuar njërin prej tyre, ashtu siç është parashikuar në pikën 32 dhe 49 të vendimit nr. 4 të KED-së. Këshilli është në kushtet që mund të kryejë njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje për të rivlerësuar rishpalljen e thirrjes. Nëse do të kemi një vendimmarrje nga Gjykata e Apelit për prishjen e vendimit të KED-së, kandidatit që është në proces hetimi nuk i mohohet e drejta për të rivazhduar me procedurën e verifikimit, ashtu siç e ka parashikuar pika 49 e vendimit nr. 4. Konkretisht unë jam e mendimit jemi në kushtet të njoftojmë subjektin për rishpallje”.

**Saida Dollani** falënderon falenderon zv/Kkryetaren që i dha zë shqetësimit të saj dhe shprehet se: “Unë i bashkohem për të mos bërë tejzgjatje të fjalës së zj. Papajorgji. Jam për rishpallje dhe kam përballë dy dispozita ligjore që është neni 238 i ligjit nr.115 i vitit 2016, i cili në pikën tre të tij parashikon se ankimi nuk pezullon zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe verifikimit paraprak nga KED-ja sipas nenit 240 të këtij ligji, që në fakt ka të bëjë me kriteret e vlerësimit. Po ashtu kam përballë dhe aktin nënligjor të dalë në bazë të nenit 229 të njëjtë ligj që parashikon vendosjen e pezullimit të procedurave të verifikimit të kandidaturës dhe për të njoftuar subjektin e emërimit për rishpallje. Sidoqoftë nëse shumica do të arrijë në konkluzionin që duhet vendosur pezullimi është shumë me e volitshme të vendoset pezullimi i verifikimit qoftë dhe i një kandidature që ka mbetur në procesin e ankimimit dhe t’i referoheni duke iu drejtuar organeve të emërtesës thirrjen. Sidoqoftë numri i kandidatëve ka rënë nën tre. Edhe sikur të supozohet se do të priset vendimi i marrë nga KED përsëri gjendemi në kushtet e parashikuara nga neni 49, kështu që nuk i lëviz as një presje asaj që tha zj. Papajorgji, jam për t’ju drejtuar organeve të emërtesës”.

**Ludovik Doda** është dakord me kolegët si për bazën ligjore si për rishpalljen.

**Fatjona Memcaj** merr fjalën: “Jam dakord të vazhdohet me subjektin që ka dhënë ligji për të vlerësuar rishpalljen për të dyja kandidaturat. Nuk gjej ndonjë problem në të dyja dispozitat e parashikuara nga vendimi nr. 4 që na pengojnë në gjendjen e faktit për të cilën jemi. Nuk mendoj se ka nevojë për ndryshime për të qenë jashtë kontekstit për ligjin që kemi miratuar do të sugjeroja që dhe gjendja e faktit është një kandidaturë që duke kontestuar vendimin e ndalimit në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë t’i vihet në dijeni vetë subjektit që të di cila është gjendja, të jetë dhe përballë asaj që kjo vendimmarrje e jona e ndalimit mund të ndryshohet mund të rrëzohet nga ana e Gjykatës së Apelit. Jam dakord me dërgimin për rishpallje, por duhen njoftuar dhe organet e emërtesës për gjendjen”.

**Arjan Qafa** shpreh qëndrimin se: “Sa i përket rastit dhe unë jam i mendimit që sipas Kushtetueses dhe akteve ligjore natyrisht është e përcaktuar nga ligji që duhet të jetë neni 3. Por problemi im është neni 36 i K.Pr.Civile që thotë se asnjë institucion tjetër administrativ nuk mund të shqyrtojë një çështje që është në procedurë gjyqësore. Për sa kohë që ne kemi dijeni se kjo çështje është në procedurë gjyqësore kjo është pak... Nëse e kalojmë këtë të vijojmë se procedura është krejt normale”.

**Vitore Tusha** shprehet: “Po marrim rastin që është një kandidat nuk po marrim rastin që kemi zero kandidatë. Supozojmë që kemi një kandidat. Kështu e parashtrova në fillim. Ne nuk jemi duke analizuar sot se çfarë vendimmarrjeje do të marrë gjykata që të ketë një shqetësim në kuptimin e nenit që ju thatë. Ne nuk po trajtojmë një çështje që është në gjykim. Kandidati është i përfshirë dhe është akoma në garë”.

**Arjan Qafa** sqaron se në referim të ligjit të gjithë kandidatëve që iu rrëzohet kërkesa kanë të drejtë për të bërë ankim për shkelje procedurale. Ai shprehet se në Gjykatën e Apelit Administrativ rishikohet çështja për shkelje procedurale dhe ky është merak i tij që mund ta trajtojnë për shkelje procedurale. Parimisht është dakord me shumicën.

**Saida Dollani** merr fjalën: “Referuar asaj që tha z.Qafa, në referim të nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile që është juridiksioni dhe, nuk është fare çështja e juridiksionit, por është një shqyrtim administrativ gjyqësia. Ne nuk po i futemi fare gjyqësisë nëse sa i drejtë apo i padrejtë është vendimi ynë dhe nuk po marrim fare në shqyrtim një çështje që i përket asaj gjykate, kështu që nuk ka asnjë lloj papajtueshmërie, përplasje apo kundërshti”...

**Arjan Qafa** dëshiron të shprehet për procedurë dhe thotë: “Duke pasur afatin e përcaktuar në ligj që është brenda 7 ditëve, Gjykata e Apelit Administrativ duhet ta trajtojë rastin. Mendoj që jemi në ditët e fundit se 7 ditë e ka ligji .

**Saida Dollani** sqaron: “Ju kërkoj ndjesë, por në favor të saj që duhet t’iu drejtohem organeve të emërtesës vjen dhe dispozita e nenit 238, e cila nuk të pengon në renditje. Nuk mund të diskutohet kur bie numri 3 për të njoftuar organet e emërtesës. Kjo të jetë për t’u bërë sa më shpejt procedura”.

**Fatjona Memcaj** sqaron se nga eksperiencia dy raste kanë pasur. Ajo thotë: “Së pari, fakti që ne i dërgojmë organit të emërtesës nuk do të thotë automatikisht ata ta çmojnë që të shpallet, kjo është në çmimin e tyre, në vlerësimin e tyre. Së dyti, qofsha e gabuar, vitin që shkoi përfaqësuesi i organit të emërtesës, meqenëse ishim në një situatë të tillë pothuajse të ngjashme, kanë pranuar që t’u dërgohet njoftimi dhe do ta ndiqni në vijim edhe situatën gjyqësore. Nuk e di sot qëndrimin e organeve të emërtesës. Kjo është në tagrin e tyre, nuk me

takon mua, por po them që t’i lejojmë dhe ata pastaj këshilli le të shprehet. Po përsëris thjesht se çfarë praktike kemi pasur vitin e kaluar”.

**Erinda Ballanca** merr fjalën: “Kjo është një çështje e përsëritur, ky është një debat i përsëritur për shkak të KED-së së mëparshme. Tani ka një qëndrim të mbajtur nga KED-ja, që ka detyrim t’u çojë 3 kandidatë, por secili nga organet e emërtesës e vlerëson vetë nëse e bën zgjedhjen mbi bazën e 1 anëtari, 2 apo 3 anëtarëve, ky është mirëkuptimi i tyre, secilit me këtë çështje, thënë kjo dhe duke parë edhe qëndrimin e organeve të emërtesës, të cilat duket sikur ju vë një lloj përgjegjësie KED-it se për më shumë se një vit, meqenëse e kanë dorëzuar përpara një viti listat apo vakancat e shpallura duket sikur ne nuk kemi mbyllur procedurën, KED-i nuk ka përmbyllur procedurën e verifikimit të këtyre kandidatëve apo të vlerësimit eventual ne do të kishim kandidat. Mendoj që ky do të ishte një veprim që dhe nëpërmjet njoftimit të tregonte realitetin vërtet se ku jemi dhe në cilën pikë këshilli është. Unë gjithsesi mendoj se mund të këtë ndonjë ndikim në lidhje me ndonjë afat nëse ndonjëri prej organeve do të pranonte që të vijonte ose shpallte me potencialitetin me një kandidat, atëherë do të na kthente një përgjigje të na thoshte, po jam dakord do të pres që ta shpall me një kandidat kështu vijoni me vlerësimin eventual të këtij kandidati. Megjithatë në atë fazë procedura e vlerësimit do të ishte e parëndësishme dhe kjo një çështje e të qenit automatike. Unë gjithsesi vlerësoj që këshilli duhet t’u bëjë me dije organeve të emërtesës se numri ka rënë nën 3, për sa i përket çështjes se pezullimit unë mendoj se nuk jemi përpara rastit të pezullimit personalisht është për faktin nuk kemi, se me tej ndonjë afat tjetër. Shkaku i pezullimit kur është diskutuar në mbledhjen e bërjes së rregullave ka qenë vetëm që ne të mos na ecnin afatet e përcaktuara në lidhje me vlerësimin, ky ka qenë qëllimi, të paktën unë kështu e kujtoj. Po ashtu edhe afati tërësor i përfundimit të të gjithë procesit në një mënyrë apo në një mënyrë tjetër. Kështu që duke u kujdesur them unë në njoftim, të mbahet parasysht qëndrimi që KED-ja nuk paragjykon përfundimin e gjykimit. Unë e di që nuk e paragjykojmë, por për të mos pasur kandidati, se kandidati në një mënyrë apo në një tjetër, mund të këtë pretendime për shkelje, në të gjitha rastet duhet paragjykuar vendimmarrjen sigurisht dhe në gjykimin tim duke mos pasur pezullim se mund të ankimonte dhe për përfaqësimin në gjykim për një vakance të caktuar etj. Këto janë mendimet e mia”.

**Bledar Dervishaj** shprehet: “Faleminderit znj.Kryetare! Ne përfaqësuesve të Presidencës ndonjëherë na thonë se zgjatemi shumë, por në të vërtetë jemi shterues në arsyetimet tona, për t’i shkuar gjësë deri në fund. Dhe për ta bërë këtë duhet të kthehemi në kronologjinë e fakteve. Dy vakancat që po diskutohen, një e Presidentit dhe një e Kuvendit, se kjo është dhe radha që citon dhe Kushtetuta, janë shpallur fillimisht për aplikim në 7



shkurt 2018 nga Presidenti, 12 shkurt 2018 Kuvendi, pas ndryshimeve kushtetuese. Në atë moment të dyja këto vakanca kishin afat për t'u konsumuar 4 vjet e 2 muaj. Në 20 dhe 25 prill 2022, mbaron afati për të dyja. Në shtator-tetor të vitit të kaluar (2019) të dyja këto vakanca, të paktën tek e jona që e mbaj mend më mirë, ngelën në garë vetëm dy kandidatë zonja Regleta Panajoti dhe zoti Besnik Muçi. Për këtë shkak u njoftuam nga KED, ndërkohë që ky i fundit pezulloi procedurën. Për Kuvendin nuk e di, mesa mbaj mend në vakancën e Kuvendit nuk ngeli asnjë kandidatë në garë. Pas kësaj ne rihapëm menjëherë thirrjen për aplikim, dhe kandidatët që aplikuan iu bashkëngjitëm listë së kandidatëve që kishin ngleur në garë. Ndërkohë u krijua KED 2020 dhe filloi procesi. Pra, kjo vakancë është shqyrtuar (ka kapur 2 këshilla (KED) dhe unë nuk e shoh problemin të thjeshtë. Se dakord KED do kryejë sërish sot njoftimin e organit të emërtesës dhe ne do rihapim thirrjen. Por këtu nuk është problemi tek organi i emërtesës as te Kuvendi, as te Presidenti. Problemi, më vjen keq që e kemi thënë, por ne e kemi thënë dhe në shkresë, problemi është këtu (KED). Sepse nuk po tregohet angazhim që këto vakanca të përmbillen brenda një afati të shpejtë. Pyetja që ngremë ne si organ emërtese është: A do mundet KED-ja aktuale ta përmbyllë brenda veprimtarisë së tij (shqyrtimin e kandidaturave që mund të vijnë për këtë vakancë), se u bë hera e tretë? Jo. Po të ndjekim ecurinë se si shqyrtimi i kësaj vakance ka shkuar herën e parë-9 muaj, herën e dytë po shkojmë prapë 9 muaj, rrishton që të mos ta bëjë. Vërtet ju jeni organ kolegjal "ad hoc" me funksion njëvjeçar, por shqetësimin më të madh mbi këtë situatë nuk e ka KED-ja, e kanë organet e emërtesës, sepse në fund janë ata që emërojnë. Është për t'u shqetësuar dhe në këtë logjikë. Të më ndjesh znj. Kryetare po më duhet ta them, nga verifikimi i dokumentacionit, kjo shkresa e Presidentit nuk është se i adresohet vetëm kësaj pike të rendit të ditës, është tërësia e vlerësimit të rrethanave të faktit për të 3 vakancat. Çfarë ka ndodhur në gjithë këto ditë. Në vlerësim të të gjitha rrethanave rezulton se problemet dhe vonesat nuk vijnë vetëm nga KED, por vijnë dhe nga institucione të tjera. Disa të varura nga qeveria drejtpërdrejt, disa të pavarura pjesë e sistemit të drejtësisë dhe më duhet t'i citoj. Se po këqyrja një prej relacioneve që shqyrtohet sot, ku citohet se: KED në datë 30.01.2020 i dërgon shkresë Prokurorisë së Përgjithshme për të verifikuar nëse këta kandidatë janë në fushën e ndalimit të ligjit ose jo. Prokuroria e Përgjithshme përgjigjet në 08.06.2020 (pas 5 muaj) kështu është fakti. KED në 30.01.2020 i dërgon shkresë SHÇBA-së të Ministrisë së Brendshme, pra ministrit të Brendshëm, që e ka në varësi direkte SHÇBA-në. Dhe turpi më i madh, qëndron tek fakti që ky autoritet më 09.09.2020 i kthen përgjigje KED, kjo për të gjithë kandidatët. Pra, këtu kemi prapë një bllok nga qeveria, ka bllok nga ministri i Brendshëm, SHÇBA-ja. Kështu i bie, se është 9 muaj afati që i është dashur këtij organi

(SHÇBA), për një shkresë për t'i thënë KED që ky person nuk ka aktivitet kriminal. Vijnë tek tjetra KQZ i pavarur me Kushtetutë, apo me ligj, sot dihet se si është bërë, mos ta zë me gojë. Edhe KQZ nga relacionet që kishte hartuar znj. Miranda Andoni, thoshte se ju ripërsërit kërkesa 21.08, më 12.08, më 12.07..., pra ka pasur kërkesë me para dhe nuk është shqetësuar KQZ për t'i kthyer përgjigje KED, nëse një kandidat është një anëtar apo drejtues i një partie politike, apo jo. Pastaj shkojmë tek KED-ja. Edhe këtu mund ta përshijmë KED-në me jo pak vonesë, që vetëm në muajin korrik i 7 (shtati) kujtohet t'u drejtojë shkresë partive politike nëse ka pasur apo i ka këta shtetas drejtues të tyre apo jo. Nën këtë logjikë të konstatimeve, që ju nuk do duhet të mërzhiteni së janë konstatime, u hartua dhe kjo shkresë e Presidentit. Tani çfarë vjen më mbrapa? Njoftimi i organit të emërtesës për herë të tretë. Kur do të formohet Gjykata Kushtetuese citon Presidenti? Këto janë shqetësime. Cilat janë këto vonesa dhe në qoftë se kishim këto vonesa me diferenca në 6 muaj kohë, në 9 muaj kohë, kjo KED nuk gjeti kohë të mblidhej e ta ngrinte si shqetësim me zërin fort? Se e ka pasur mundësinë. Përfaqësuesin e Kuvendit e ka pasur këtu në mbledhje, ka pasur mundësi në Këshillin e Integritimit Evropian të ngrinte këtë shqetësim. Ka qenë pikërisht ish-Kryetari i KED, i cili ka deklaruar se i kemi gati dhe i mbyllim në korrik shqyrtimin e këtyre tre vakancave. Në shkresën e Presidentit ne i kemi thënë dhe cituar këto problematika. Të gjitha këto fakte dhe rrethana tregojnë për një gjë tjetër, jo për vështirësi nga organet e emërtesës, as për pengesë prej tyre, sepse ne, sa na ka ardhur njoftimi prej KED, të nesërmen e kemi publikuar thirrjen (për vakancën). Por është problem i veprimtarisë së KED-së, e cila të paktën duhet t'i kishte bërë publike këto vonesa. Të gjente kohën të mblidhej e të vendoste apo t'i shkruante Presidentit edhe Kuvendit. T'i thoshte: ju me keni sjellë ca lista, por unë nuk po mundem t'i shqyrtoj, sepse po më bllokun SHÇBA-ja, Prokurori i Përgjithshëm dhe/apo KQZ-ja, që dihet se çfarë përbërje ka. Sepse mos dhënia e këtij informacioni për dy organet e emërtesës bën të besohet çfarë? Si po ecën kjo veprimtari? Çfarë besimi duhet të kemi se do të përmyllet shqyrtimi i këtyre vakancave deri në dhjetor?! Flas si përfaqësues i institucionit të Presidentit. Kështu që është në vlerësimin tuaj dërgimi i njoftim tek ne si organ emërtese dhe është e drejta juaj e vendimmarrjes. Pastaj me ardhjen e njoftimit do të vendosim ne se çfarë do të bëjmë.

**Mimoza Arbi** shprehet: “Në lidhje me pikën 3 të rendit të ditës jemi duke diskutuar dhe është pikërisht rishpallja e thirrjes për rikandidim nga organet e emërtesës, pikërisht Kuvendit të Shqipërisë dhe Presidentit të Republikës. Duke iu referuar pikërisht aspektit ligjor dhe nënligjor që vepron KED-ja është e vërtetë që jemi në kushtet e rënies se numrit minimal që KED-ja duhet t'i paraqesë organeve të emërtesës për këto vende vakante, si

pretendohet që kemi vetëm një kandidat për të cilin KED-ja ka vendosur ndalimin e kandidimit, por që është verifikuar që ky kandidat është në kushtet e shqyrtimit të fazës së ankimit në gjykatën administrative. Është vetë në kompetencë të KED-së për t'ju drejtuar organeve të emërtesës siç është përmendur atëherë që kemi një kandidat për të dyja organet e emërtesës, pra i bie dhe për Presidentin dhe për Kuvendin dhe kjo sjell vështirësi dhe në aspektin praktik. Edhe fakti që ai i është drejtuar gjykatës administrative nuk është pengesë për t'ju drejtuar organeve të emërtesës. Një praktike e tillë ka qenë dhe para rishpalljes të këtij vendi vakant nga Kuvendi në 21.08, ku kishte rënë numri i kandidatëve dhe ka një ish-kandidat si z.Sinan Tafaj që i ishte drejtuar gjykatës administrative megjithatë KED-ja iu drejtua Kuvendit për rishpallje. Është Kuvendi pastaj si organ emërtesë si do ta vlerësojë do ta bëjë rishpalljen apo jo. Ajo që më shqetëson mua, është shqetësim që ngriti dhe përfaqësuesi i Presidentit pikërisht me, cila do jete koha apo vonesa për shqyrtimin e kandidaturave duke ditur që edhe mandati i parakohshëm i mbetur në dispozicion është pothuajse as 1 vit e 6 muaj nga ky moment që ne flasim dhe kjo do të shqetësojë qoftë prurjen e kandidateve por dhe që është pastaj fazë e shqetësimit të verifikimit të kriterëve të këtyre kandidateve. Kjo do kërkojë një bashkëpunim shumë të madh gjykoj unë të vet KED me organet apo institucionet që japin informacion. Pra nga materialet apo dokumentacioni që na është vënë përpara konstatojmë që edhe vet KED me vonese u është drejtuar këtyre organeve por dhe këto me vonese kanë kthyer një përgjigje, ndoshta një bashkëpunim, ndoshta dhe me te drejtë përfaqësuesi i Presidentit ngriti që ky shqetësim duhet bërë zyrtar duke ju drejtuar dhe institucioneve të emërtesës për te nxitur institucionet përgjegjëse që janë ngarkuar për dhënien e këtij informacioni KED sa me parë në mënyrë që të përfundojë dhe ky proces i vlerësimit të kandidateve dhe ndoshta se shpejti Gjykata Kushtetuese bëhet funksionale”.

**Saida Dollani** thotë: “Marr shkas nga fjala e znj. Mimoza, meqenëse është rasti, ju jini përfaqësuesja e Kuvendit dhe jo pa qëllim ligjvënësi ka parashikuar që ju te ftoheni në këto mbledhje qoftë dhe për të parë që janë organe të reja pa diskutim që gjate veprimtarisë të tyre gjithmonë here pas here do t'ju dalin probleme. Siç u evidentua ishte shumë i sakte përfaqësuesi i Presidentit, për citimet e disa akteve, ju është referuar në janar dhe përgjigjja ka ardhur në korrik, ..., nëse e shikoni të mundur që ti referoni organit që ju përfaqësoni... këtë fakt ...në mënyrë analoge psh: ligjvënësi, pra Kuvendi i Shqipërisë, ka parashikuar për organet e rivlerësimit një bashkëpunim 15 ditor duke parashikuar dhe sanksionin e përgjegjësisë penale ... për shpërdorim detyre. Të parashikohet një gjë e tillë dhe tek ligji 115, që në rast se KED i drejtohet dhe brenda 15 ditëve nuk vjen kjo përgjigje nga organet, sepse

varet fati i ngritjes së një institucioni shumë të rëndësishëm, aq sa përben dhe kusht për futjen tonë në BE, apo çeljen e negociatave ... por kryesorja është që qytetarët shqiptarë kanë nevojë për Gjykatën Kushtetuese .... Kështu që në analogji duke ju referuar ligjvënësi asaj dispozite në mos gaboj duhet të jete neni 62 i ligjit 84/2016 ta vendosi edhe për KED. Brenda 15 ditëve organi që i drejtohet mban përgjegjësi për shpërdorim detyre. .... Ju faleminderit”.

**Mimoza Arbi** rimerr fjalën: “Po ju them se mbas çdo mbledhje ku marr pjesë do t’i bej informacion Kryetarit të Kuvendit, sepse kam një detyrim ti them çfarë është konstatuar dhe pikërisht këtë që ju sapo parashtruat unë kam bërë një material para disa ditësh ja kam dhënë dhe Kryetarit të Kuvendit në kuadër të disa rregullimeve ndryshimeve të aspektit ligjor mbi bazën e të cilave funksionon KED. Të gjitha këto do ua bej me dije”.

**Bledar Dervishaj** rimerr fjalën: “Faktikisht Shqipëria nuk vuan për legjislacion, që rregullon komunikimin e institucioneve ndërmjet njeri-tjetrit. Edhe KED si institucion që drejton shkresa të gjitha autoriteteve dhe këta të fundit kanë përgjegjësi se janë funksionarë të administratës shtetërore. Ka një ligj për administratën shtetërore ka një Kod të Procedurave Administrative që kanë afate, 45 ditë është afati maksimal për të kthyer një përgjigje. Duan s`duan ata, janë në shpërdorim të asaj detyre publike që ju është ngarkuar. Po të shikosh sjelljen e këtyre organeve përkundrejt institucioneve të tjera, në disa raste janë efikas, shumë urgjent. DSIK psh brenda 2 ditëve e kishte verifikuar pastërtinë e figurës për ministrin e propozuar për të qenë Ministër i Jashtëm. Apo kur kryen vettingun e Drejtuesve të Policisë së Shtetit, SHÇBA që ka për detyrë të hartojë raporte, i bën shumë shpejt raportet e tyre, të paktën nga informacioni që jepet publikisht. E ndërkohë po kështu dhe Prokuroria e Përgjithshme për kandidatë të ndryshëm që zgjidhen nga organe të tjera kushtetuese. Këto vonesa 5 muaj Prokuroria e Përgjithshme, SHÇBA me 9-muaj janë tregues i madh që dhe KED-në, duhet ta kishte shqetësuar. Unë i përmenda këto fakte këtu që t’i dëgjonte dhe përfaqësuesja e Ambasadës Amerikane që kanë të njëjtin shqetësim si ju. Ne do t’ia bëjmë me shkresë dhe të gjitha këto detaje që janë evidentuar dhe janë konstatuar. Të shikojmë çdo të bëhet në këtë mbledhje, dhe do t’i bëjmë me shkresë të gjitha e do t’i bëjmë publike po njësoj si kjo sot. Situata është serioze dhe dikush duhet të mbajë përgjegjësi. Kështu që, në qoftë se Kuvendi, me fal Moza se diskutojmë këtu, ndjen boshllëqe ligjore le t’i plotësojë, por për atë që ka ndodhur në fakt, ka ligje! KED nga janari në qershor, të paktën duhet ta kishte shqetësuar kjo gjë!. Një shkresë Kuvendit dhe një shkresë Presidentit, duhet t’ia kishte dërguar.

**Vitore Tusha** ndërhyr duke dashur të mos krijohet keqkuptim në lidhje me shkresat e dërguara nga SHÇKB-ja, DSIK-ja dhe KQZ-ja, dhe sqaron se KED-ja i ka dërguar shkresën

SHÇKB-së në fund të janarit, ndërsa përgjigjja është kthyer me shkresë konfidenciale në datën 10 shkurt, shkresë e cila nuk mund të këqyrej nga relatorja, pasi ajo nuk ishte e pajisur me certifikatën e sigurisë. Relatorja ka informuar se relacionet për disa kandidatë i kishte të përgatitura, përveçse në to nuk ishte përfshirë përgjigjja e ardhur nga SHÇKB-ja. Ka verifikuar këtë problem dhe ka konstatuar, që shkresa nuk përmbante përgjigje për njërin nga pyetjet e shtruara, pas angazhimit të saj, institucioni i SHÇKB-së ka kthyer përgjigje menjëherë.

Në lidhje me pajisjen e anëtarëve të saj me certifikata sigurie, KED-ja ka komunikuar me DSIK-në me shkresë zyrtare vetëm në muajin korrik, megjithëse duhet të ishte më e angazhuar në kryerjen e këtyre procedurave. Ndërsa komunikimi me KQZ-në, e cila është përgjigjur menjëherë, është realizuar pas kërkesës së zonjës Ballanca në mbledhjen e muajit Korrik të këtij viti, që në procesin e verifikimit të kandidatëve lidhur me kriterin e mosmbajtjes së pozicioneve drejtuese gjatë 10 vjetëve të fundit, të përfshihen edhe parti të tjera, adresat e të cilave mund t'i dispononte KQZ-ja. E gjithë procedura e komunikimit me 53 subjekte parti politike është kryer në fund të muajit korrik dhe gjatë muajit gusht.

**Bledar Dervishaj** sqaron: “Për të qenë të qartë, në qoftë se në relacione janë thënë kështu, se unë me këtë dokument njihem, me relacionin. Se duket sikur sfumohet fakti, por fakti është që datat në relacion referojnë që Prokuroria e Përgjithshme ka dashur 5 muaj të kthejë përgjigje, SHÇBA ka kthyer përgjigje në 09.09.2020. Kështu thuhet në relacion, këtë lexojmë të gjithë.

**Vitore Tusha** vijon me vendimmarrjen në lidhje me piken e 3-të të rendit të ditës, e cila lidhet me diskutimin që sapo u bë, për dërgimin e njoftimit organeve të emërtesës Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë, në lidhje me rënien e numrit të vakancave përkatëse nën 3(tre).

Ftohen anëtarët që të votojnë vendimin me përmbajtje si vijon: “Njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje Kuvendin e Republikës për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, e shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe të rishpallur në datën 21.08.2019”.

**Anëtarët e Këshillit** ranë dakord dhe miratuan vendimin për përcjelljen e njoftimit Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për rishpalljen e thirrjes, për paraqitjen e kandidaturave.

**Vitore Tusha** fton anëtarët që të votojnë vendimin me përmbajtje si vijon: “Njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje Presidentin e Republikës për të vlerësuar rishpalljen e

thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe e rishpallur në datë 27.09.2019.

**Anëtarët e Këshillit** ranë dakord dhe miratuan vendimin për përcjelljen e njoftimit Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për rishpalljen e thirrjes, për paraqitjen e kandidaturave.

**Vitore Tusha** sqaron se vendimet e marra së bashku me të gjitha materialet përkatëse do t'i njoftohen në një kohë shumë të shpejtë organeve të emërtesës, Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

**Këshilli** vijon me pikën e 4-t të rendit të ditës. “Diskutimi lidhur me njoftim qëndrimin e përcjellë nga z.Ardian Dvorani në e-mail-in e datës 20.08.2020”.

**Vitore Tusha** shprehet se në lidhje me këtë çështje po bën një shpjegim: “Unë nuk kam vlerësuar të jap një opinion paraprak, një informacion paraprak, se informacioni i është përcjellë të gjithëve me të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën formë. Aq më tepër që në mbledhjen e shkuar çështja u soll në vëmendje, pavarësisht se Këshilli nuk diskutoi rreth thelbit të njoftimit duke e lënë për ta diskutuar në ditët në vijim. Ju jeni në dijeni mbi lajmërimin që unë i kam bërë z.Dvorani, për të marrë pjesë në mbledhje. Përmes njoftim qëndrimit, z. Dvorani ka shpjeguar së pari, qëndrimin e tij në lidhje me këtë pozicion dhe, së dyti, i ka kërkuar KED që të marre një vendim në lidhje me këtë çështje. Në këtë kuptim edhe për këtë shkak unë vlerësova që ta diskutojmë së bashku nëse duhet ta thërras në mbledhje apo jo. Njoftim qëndrimi i përcjellë nga z.Dvorani në dt. 20.08.2020 ,dhe që iu është prezent ju të gjithëve, përmban në mënyrë të përmbledhur këto elemente që prezantova. Nuk e shoh me vend që ta rilexoj, në qoftë se ka nevojë mund ta bëj një gjë të tillë. Në qoftë se keni nevojë për ndonjë informacion, dua të them paraprakisht që asnjë institucion i shtetit shqiptar nuk ka komunikuar me KED në lidhje me vendimmarrjet në drejtim të z.Dvorani. Domethënë këtu kam parasysh KLGJ, e cila nuk ka bërë asnjë komunikim dhe as ka përcjellë asnjë vendim, as në lidhje me njoftimin që i është bërë për ndërprerjen e qëndrimit apo të emërimit të tij. Pra, nuk ka patur asnjë komunikim midis KED dhe KLGJ në lidhje me këtë çështje. Unë mendoj që institucionet duhet të komunikojnë edhe në këtë proces, siç komunikojnë në procesin nga përgatitja e listave dhe deri sa realizohet shorti të komunikojnë dhe më tej deri në përfundimin e mandatit një vjeçar. Siç e thashë nuk kemi asnjë dokument zyrtar, prandaj pa dëgjuar diskutimin dhe në varësi të diskutimit tuaj mund të lindë nevoja që të merren dokumentet ose jo. Ju ftoj të shprehni opinionin tuaj në lidhje me këtë kërkesë,

është i rëndësishëm, pasi vendimmarrja jonë lidhet me qenien e tij anëtar i KED, dhe, për rrjedhojë, thirrjen e tij në këtë mbledhje”.

**Fiona Papajorgji** u shpreh se në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, që kur ka ardhur njoftimi nga z. Dvorani, është shprehur se ka qenë e gatshme të diskutoj, për shkak të faktit se një çështje e ngjashme është diskutuar edhe më parë, konkretisht që në mbledhjen e parë të konstituimit të KED 2020, ku në thelb KED-ja ka mbajtur qëndrimin se nuk ka kompetencën për tu shprehur mbi mandatin e një anëtari të saj, pasi kjo nuk është parashikuar as në ligj dhe as në aktet nënligjore që rregullojnë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KED-së. Ajo tha: “qëndron fakti i parashtruar nga zv.Kryetarja, ne nuk kemi asnjë komunikim nga organet e KLGJ-së, por pavarësisht kësaj, qëndrimi i KED-së, të cilit i qëndroj përsëri, ka qenë që vet anëtari ka përgjegjësi nëse përmbush kushtet për të qenë apo jo anëtar i KED-së, kushte që duhet të jenë si në momentin që bëhet shorti për përzgjedhjen e anëtarëve të KED-së, ashtu edhe gjatë gjithë veprimtarisë së saj. Ndërkohë po në mbledhjen e parë të KED-së, në parim të gjithë kemi qenë të një mendimi, anëtarët por dhe pjesëmarrësit e tjerë në mbledhje, që do të ishte më mirë prezenca e sa më shumë anëtarëve të KED-së, si për diversitet të mendimit, por edhe për faktin sepse për shkaqe të ndryshme ndonjë nga anëtarët mund të humbi statusin e të qenurit anëtar i KED-së, dhe ne mund të gjendemi hipotetikisht, edhe në kushte që nuk mund të mblidhemi për të marrë vendime”.

**Arta Marku** sqaron se ishte dakord me çka shprehu znj.Papajorgji dhe shton: “Nuk dua të shtoj asgjë asaj që ajo tha, është rast i përsëritur, rasti tjetër ka qene rasti im, nuk është në kompetencën e KED-së të shprehet”.

**Miranda Andoni** shprehet se ky qëndrim ka qenë i mbajtur dhe nga ana e saj.

**Saida Dollani** shprehet: “Në respektim të rendit të ditës, unë kam të njëjtin qëndrim që tha dhe znj.Papajorgji. Objekti i veprimtarisë së KED është shqyrtimi i kandidaturave për në Gjykatën Kushtetuese dhe nuk është aspak qëndrimi apo sjellja e çdo anëtari të KED-së përveç përgjegjësisë disiplinore që ka, por edhe ajo nuk është se përcaktohet. Kështu që çdo anëtar qëndrimin e tij e shikon vet në përputhje me ligjin dhe jo me kot tashme Kushtetuta parashikon qofte dhe ligji specifik që të gjithë janë gjyqtare ose prokurore që do të thotë se e njohin shumë mirë ligjin. Nuk kam çfarë të shpreh asnjë lloj opinion”.

**Ludovik Dodaj** sqaron: “Këtë qëndrim kemi mbajtur dhe këtë barrë s`kemi pse ta marrim përsipër, sepse nuk na e parashikon ligji asgjëkund. Le të shprehen ekspertet siç u shprehen për znj.Marku.

**Arjan Qafa** shprehet se mban të njëjtin qëndrim me koleget. Nuk është objekt i veprimtarisë së Këshillit trajtimi i mandatit apo prezencës së njërit prej anëtarëve. Secili qëndrimin e vet e shfaq në format e kërkuara nga ligji, thotë ai.

**Vitore Tusha** shpreh qëndrimin e saj: “Në vijim të diskutimeve të mbledhjes të Këshillit të datës 21.08.2020 në rendin e ditës është përcaktuar si çështje edhe diskutimi lidhur me “Njoftim qëndrimi” të përcjellë nga zoti Ardian Dvorani me e-mail-in e datës 20.08.2020, pas thirrjes së tij për mbledhjen e KED-së të datës 21.08.2020.

Në parashtrimin e tij, siç edhe jeni në dijeni, zoti Dvorani ka përcjellë argumentet që përlligjin qëndrimin e tij si anëtar i këtij Këshillit dhe motivin e mospjesëmarrjes në këtë mbledhje. Gjithashtu, zoti Dvorani kërkon vendimmarrjen e domosdoshme të Këshillit për vijueshmërinë ose jo të ushtrimit të detyrës si anëtar i KED-së.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është një organ kolegjal, i krijuar nga Kushtetuta, e cila ka përcaktuar mënyrën e krijimit, funksionimit si edhe kompetencat e tij, që më tej janë zbërthyer dhe detajuar në dispozitat e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Gjatë ushtrimit të këtyre kompetencave, ky organ është i detyruar të respektojë parimin e ndarjes së pushteteve, parim që buron nga neni 7 i Kushtetutës, i cili nënkupton që çdo organ është i detyruar të përmbushë kompetencat që i janë dhënë në mënyrë të shprehur në Kushtetutë dhe në ligj.

Sipas nenit 149/d, pika 3, të Kushtetutës, anëtarët e KED-së përzgjidhen me short nga Presidenti i Republikës, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve që plotësojnë kriteret kushtetuese dhe ligjore. Kriteret dhe kushtet ligjore për tu përfshirë në këtë short, si dhe procedurat e përzgjedhjes së magjistratëve janë përcaktuar në nenin 221 të ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar me ligjin nr. 47/2019.

Për qëllime të këtij procesi, ligji ka përfshirë disa organe me kompetenca të përcaktuara qartë, siç janë KLGJ-ja, KLP-ja, Gjykata Kushtetuese, të cilat përgatisin dhe dërgojnë pranë Presidentit të Republikës listat e kandidatëve që plotësojnë kushtet për anëtarë të KED-së. Pas përfundimit të këtij procesi dhe krijimit të KED-së, asnjë dispozitë ligjore nuk parashikon përfundimin e mandatit si anëtar i KED-së për shkak të ndryshimit të funksionit që ushtron gjatë vitit, në raport me pozicionin që mbante në momentin e hedhjes së shortit.

Përgjatë këtyre viteve të funksionimit të KED-së, ka pasur disa raste kur disa anëtarë të përzgjedhur të saj, si zoti Ismalaj (KED 2019) dhe zonja Velçani (KED 2020), duke qenë në proces rivlerësimi janë shkarkuar me vendim të KPK-së, vendim që është marrë gjatë ushtrimit të mandatit si anëtar i Këshillit në rastin e parë dhe pas hedhjes së shortit në rastin tjetër. Pas vendimit të KPK-së rezulton se këta anëtarë nuk janë thirrur nga kryetari i KED-së



për të marrë pjesë në mbledhjet e këtij organi. Në këto raste ka pasur një vendimmarrje nga organet e vettingut për shkarkimin nga detyra që mbanin këta dy anëtarë dhe nuk ka pasur asnjë vendimmarrje nga vetë KED-ja.

Po ashtu, një rast tjetër që i është sjellë në vëmendje KED-së është rasti kur anëtari që ka mbajtur një detyrë të caktuar në momentin e përzgjedhjes me short, ka ndryshuar pas këtij momenti funksionin, siç është rasti i zonjës Arta Marku, e cila në momentin e përzgjedhjes si anëtare e KED-së 2020 ushtronte funksionin e saj në Prokurorinë e Përgjithshme dhe përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së këtij organi e ushtron funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Edhe në këtë rast, i cili është diskutuar në mbledhjen e datës 15.01.2020, nuk ka asnjë vendimmarrje nga ana e KED-së.

Në vlerësimin tim, siç jam shprehur edhe më parë, kompetencat e Këshillit janë qartësisht të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji dhe ky organ nuk e ka të parashikuar të shprehet për mbarimin e mandatit të anëtarit të Këshillit. Për rrjedhojë, ky Këshill nuk ka kompetencën të vlerësojë apo të shprehet në lidhje me mandatin e anëtarit të Këshillit dhe se rastet e papajtueshmërisë apo mbarimit të mandatit të anëtarit të KED-së, janë çështje që duhet të vlerësohen nga organet e ngarkuara për verifikimin e kriterëve ligjore për krijimin e KED-së. Në kuptim të sa më sipër, për të garantuar ushtrimin e funksioneve në përputhje me funksionet e dhëna çdo organi, vlerësoj se komunikimi institucional dhe bashkëpunimi mes të gjitha organeve të ngarkuara nga ligji duhet të funksionojë përgjatë ushtrimit të gjithë veprimtarisë së anëtarëve të zgjedhur të KED-së”.

**Erinda Ballanca** sqaron: “Ky është një rast në fakt jo si rastet e tjera për të cilat ne kemi diskutuar ose ka pikëpyetje me rastet e tjera që kanë ndodhur me parë por ka dhe diferencë. Është e qartë për këdo se mbarimi i detyrës si anëtar i KED ndodh në momentin kur një nga anëtarët humbet statusin e magjistratit pra humbja e statusit të magjistratit mund të jetë për arsye të ndryshme, një nga shkaqet e humbjes se këtij statusi është dhe vendimi i KPK për efekt të moskalimit të procesit të verifikimit apo daljes në pension, për shkak të dhjetra rasteve, për shkaqe dhe arsye të tjera apo për shkak të përfundimit të mandatit funksional, mandat i cili duhet të kujtoj për anëtarin në fjale ka përfunduar shume kohe përpara se sa të ketë përfunduar dhe në realitet si mandat kushtetues i përcaktuar. Ka pasur një debat shumë të gjatë që në KED e parë, unë jo më kot ju kam kërkuar me shkresë më parë dhe në kuptim të transparencës, që në fakt unë e vlerësoj është një veprim i duhur dhe një sjellje e duhur e gjithë anëtarëve të KED për ta kuptuar transparencën e këtij Këshilli, si një nevojë të secilit prej nesh që të ketë mundësi të konsultohet me çfarë është thënë, çfarë qëndrimesh kemi mbajtur çfarë diskutimesh janë bërë në këtë Këshill që nga dita 1 deri në

ditën e fundit. Për këtë arsye unë përpara 10 ditësh, që në datën 2 u jam drejtuar me shkresë për të përfituar një koje të transkriptit të mbledhjes së pare të KED kur është diskutuar për here te parë çështja e konstituimit dhe aty ka qenë debati i parë thelbësor në të cilin kemi diskutuar dhe kemi thënë, a ka ndonjë detyre KED që të legjitimoje apo verifikojë ekzistencën e mandatit që ata kane. A ka ndonjë detyre anëtari të shprehet në lidhje me faktin a e gjen apo jo veten në përputhje me kushtet ligjore në përputhje me ushtrimin e detyrës. Kam referuar në atë mbledhje në mënyrë të posaçme për ata anëtare qe kane qene, se reforma në drejtësi përcaktoi një standard tjetër të zbatimit te ligjit për secilin prej anëtarëve të sistemit të drejtësisë. Nëse me pare ne mendonin nuk është përgjegjësi e imja, nëse dikush me jep një kredi ne kundërshtim me kushtet e ligjit apo nuk është përgjegjësi e imja nëse dikush do përfitojë një çmim preferencial por nga ky çmim preferencial unë s`kam bërë ndonjë gjë, por mbetet gjithsesi preferencial dhe mendoj se kjo gjë mund të jetë ok, edhe kjo ndryshoj, ishte shtrirja kontraktuale dhe ky standard ndryshoi. Standardi qe gjyqtari vet duhet ta dije a ka qene ne zbatim te ligjit apo jo edhe ky standard dhe ne gjykim të këtyre vendimeve dhe faktit të një pjese të anëtarëve të KED ne gjykimin e Av.Popullit jo në gjykimin e tyre, ja u kishin zgjedhur në përputhje me kriteret e parashikuara nga ligji, unë e kam ngritur këtë çështje në mbledhje. Për të mënjeluar këtë çështje ka qenë pikërisht z.Dvorani i cili sot vjen e kërkon një qëndrim, i cili ka deklaruar, unë nuk e kam kopjen nuk mu bë i mundur transkripti por secili prej jush mund ta thotë. Ishte e pamundur, znj.Tusha. Ne kemi tentuar maksimalisht që ta dëgjonin dhe një herë për tu bindur dhe vet... për të qenë korrekt në citimin që do ti bënim. Ka qene kategorik në qëndrimin që nuk e vlerësojmë ne vet, as vet anëtarët, përjashtues komplet në këtë çështje, e vlerëson organi që e ka sjelle. Unë e quaj detyre kush e ka sjelle ai ta vlerësoje nëse jam unë apo jo kandidat, jam unë në përputhje apo s`jam. Prandaj me vjen shume çudi që pas dy vjetësh, ndryshoi qëndrimi i pare ne një moment ndryshoi disi qëndrimi, ne një moment vendosi kandidati vet në KED e vitit 2020, por tani dilet në një qëndrim komplet tjetër që praktikisht i rikërkohet KED të marrë një vendim të caktuar x, y apo z, që KED qartësisht nuk është organi që ka sjellë vet anëtarët dhe këtë gjë duhet t`ia bënte ose KLGJ, sepse KLGJ mund te jete ajo që e ka çuar, ose Presidentit i cili ka vendosur ta pranoje këtë emër në listën e atyre për të cilët është hedhur short, rasti ka qenë se as short nuk është hedhur se ka qenë kandidat i vetëm. Kështu që në këto kushte për sa i përket kërkesës që duhet të dalë me një vendim me duket një kërkesë e cila është në kundërshtim me çdo qëndrim publik te vet kandidatit qe ka mbajtur në këtë KED dhe me këtë qëndrim publik te kandidatit qe ka mbajtur në lidhje me të drejtën e KLGJ për të deklaruar përfundimin e mandatit të tij apo dhe me të drejtën e çdo organi tjetër i cili mund te ketë

ngritur ndonjëherë ndonjë problem në lidhje me faktin se një person mund të rrije në Gjykatën e Lartë për me shume se sa mund të jetë. Kjo është një çështje e cila, domethënë ky qëndrim që kam lexuar në njoftim e bërë publik në media, është totalisht me ndryshimin 180° i qëndrimit personal sa here është diskutuar në lidhje me këtë çështje. Megjithatë të gjithë ju dhe unë në lidhje me qëndrimet e veta dhe mendimet e veta, evolimi është një gjë e mire por unë shikoj që prapë dhe në rreshtat e këtij njoftimi ka qasje që interpretojnë ligjin sipas dëshirës dhe vullnetit personal apo në interpretim të një interesi të ngushte personal. Unë nuk e di se në çfarë mënyrë ky njoftim, është pikërisht njoftim qëndrimi për KED, që ka dalë në media. Ndoshta do të ishte mirë që të bëhej një hetim nga ana e KED se jemi në rastin flagrant të daljes në media të një qëndrimi i cili me ligj nuk duhet të dalë. Ne nuk na ishte bere me dije fare ekzistenca e këtij dokumenti, jam vënë në dijeni nëpërmjet mediave. Rasti i dyte që pikërisht qëndrimet e këtij kandidati dalin me pare në media sesa vijnë në KED, rasti i pare ka qenë pikërisht njoftimi i qëndrimit të tij se nuk do të merrte me pjese në KED dhe se ishte dakord që ju të vijonit kryesimin e KED. Ndoshta dhe për këtë duhet të marrim një vëmendje. Ku qëndron ndryshimi nga rasti Marku. Rasti Marku është i qartë që znj. Marku nuk e ka humbur asnjë ditë statusin e saj si magjistratë, në vendimmarrjet e KLP është bërë kujdes madje...”

**Vitore Tusha** ndërhyr duke konstatuar se ky është diskutim për thelbin e problemit.

**Erinda Ballanca** thotë përsëri: “Po pra, po kaloj në thelb por ta kemi të qartë edhe ne. Në vendimmarrjet e KLP është thënë shprehimisht se kur do të përfundonte data konkrete kur do të merrej detyra e re për znj. Marku në Prokurorinë e Apelit. Të paktën kjo është një çështje që e kemi parë dhe aktet janë publike, ndërsa në rastin konkret përfundimi i mandatit, konfirmimi ka një, ka mbaruar detyrën e magjistratit është një ish magjistrat dhe kjo është një cilësi, por kjo cilësi nuk të bën anëtar të KED. Fakti që në një moment të dytë mund ta rifitosh përsëri këtë cilësi kjo do të thotë që mund të rikthehesh përsëri në detyre, të marrim hipotetakisht shkalla e parë e hoqi një anëtar të KED nga detyra në janar, në dhjetor KPA e konfirmon, do rrije ai në dhjetor në detyrë dhe aty ka një lloj tjetër cilësie, pra ai është i pezulluar por në rastin konkret ai nuk është pezulluar. Për më tepër pavarësisht faktit çfarë ndodhi, nga data në të cilën z.Dvorani ka marrë njoftimin e pare që s`kishte me mundësi të qëndronte me në detyrë sepse praktikisht ai thotë e vlerësoj vet rri apo nuk rri në detyre. S`kishte mundësi të qëndronte në detyre deri në datë në të cilën KLGJ është shprehur me një vendim, nuk ka qene e sigurt vajtja e tij në Gjykatën e Apelit, sepse ligji thotë që shkon vetëm nëse plotësohen kriteret dhe është i qarte nuk e dimë çfarë kriteret ka plotësuar nuk i hyj asaj vendimmarrje sepse nuk është kompetence e imja. Unë dua të them që parimisht me

ato vendime qe ka marre unë nuk kam pare vendim te arsyetuar, kam parë vetëm një vendim njoftimi që prezumoj z.Dvorani se vetëm një ishte në atë datë dhe ajo është totalisht i paarsyetuar nga ana e KLGJ për të më thënë mua dhe për të me sqaruar se cilat kane qenë kriteret që zotëria i ka plotësuar qe nga dita e pare deri në të fundit. Për këtë arsye mendoj se dhe kërkesa qe i bëhet KED për t`u shprehur domosdoshmërisht me një vendim ne lidhje me këtë çështje mua me duket një kërkesë jashtë vendit, për sa kohë që vendimi i tij ka qenë i qartë, është larguar nga KED. Në qoftë se personi largohet nga një organ, nuk e di na tha do largohet për një muaj apo do marrë 3 muaj leje, nuk e di edhe ne rastin e parë, nuk kërkoji mendim të KED-së por e shprehu tek një qëndrim personal dhe nuk erdhi më në mbledhje. Ose ka bërë gabim herën e parë ose ka bërë gabim herën e dytë. Kthimi mund të krijojë një problem tjetër. Nëse zotëria do të kthehet, do kthehet si kryetar? Pyetja tjetër është: A mundet të jetë Kryetar, a mundet një magjistrat ne Apel te bëhet Kryetar, kur ligji e përcakton qartë që Kryetar i KED është një përfaqësues nga Gjykata e Larte? te gjitha këto probleme do te ishin zgjidhur, në qoftë se ligji do te ishte interpretuar në krye të herës në sensin që duhet të kishte, që nëse numri i anëtareve të KED bie, njeri nga personat largohet, do të bëhet shorti për tu zgjedhur një person tjetër qe përfaqëson atë grup. Ligji nuk e thotë këtë por interpretimi bëhet, nga korifejt e reformës në drejtësi ka qenë q është me e rëndësishme data 7 dhjetor qe do te behet shorti, se sa fakti qe ky Këshill duhet te ketë një anëtarësi e cila duhet te përfaqësoje çdo grup te përcaktuar te sistemit te drejtësisë. Te tera këto ne i kemi thënë e stërthënë edhe ne mbledhje te mëparshme për aspekte te ndryshme. Për sa i përket interpretimeve me vjen keq qe mora me shume kohe ndoshta dhe se sa u tha për këtë çështje, por besoj se kjo është një çështje shume e rëndësishme e cila duhet te marre vëmendjen e duhur dhe për te cilën duhet verifikuar ne tërësi dhe qëndrimi konkret i personit dhe prandaj, me vjen shume keq, nuk arrita dot për shkaqet tuaja teknike, doja qe tua jepja dhe ju qëndrimin e z.Dvorani ne mbledhjen e pare kur është ngritur kjo çështje. Çfarë ka deklaruar ai kur flitej ne lidhje me deklarimin e përputhshmërisë apo jo të qëndrimit të tij në detyrë. Nuk është në proces-verbal kjo, sepse proces-verbalet janë të përmbledhura, fjala ime është aty, prandaj duhet audio. Prandaj kemi pasur debatet e tjera të cilat janë shumë të rëndësishme”.

**Mimoza Arbi** merr fjalën: “U shpreha dhe në fillim që duke e konsideruar këtë si një çështje te KED, si përfaqësuese e Kuvendit nuk kam pse te prononcohem për këtë qëndrim qe do mbani ju ne lidhje me këtë kërkesë dhe nuk e kam letrën materialin qe z.Dvorani i ka drejtuar KED. Por dhe si Kuvend d.m.th mendimi im, qëndrimi im është qe kjo është çështje

qe jini ju ata qe do ta shqyrtoni dhe nese keni kuadrin ligjor per tu shprehur apo per te marre ndonje vendim”.

**Bledar Dervishaj** shprehet se Avokati i Popullit i kujtoi shumë detaje që kanë ndodhur në Këshill në vitin 2019 dhe në vitin 2020. Ai thotë: “Ashtu si kundër edhe me qëndrimin që mbajtët ju si zv.Kryetare e Këshillit, me risollët ne vëmendje disa detaje te rëndësishme ne lidhje me KED, funksionin, mënyrën se si krijohet, ku dhe kush autoritet e merr rolin e organit te emërtesës vit mbas viti. Atëherë ka qenë Kuvendi, bile nuk është diskutuar vetëm kjo çështje që thotë znj.Ballanca, por edhe nëse do të quhej Këshill i Përkohshëm i Emërimeve në Drejtësi, për të tretën herë, apo Këshill i Emërimeve ne Drejtësi. Edhe ky detaj është diskutuar, pasi lidhej me mënyrën se si ky organ po formohej, nga listat e kandidatëve të përcjella nga institucione te vjetra dhe nga lista nga 2020 të sjella nga institucione te reja. Prandaj z.Dvorani më parë, ma do mendja ka mbrojtur tezën se, “e di organi i emërtesës që më ka zgjedhur” ku ka qenë i garantuar në mendjen dhe në logjikën e tij. Ndërkohë që, organi i emërtesës këtë vit për KED 2020 ka ndryshuar për shkak se, janë vënë në funksion të dy këshillat (KLGJ dhe KLP) që sjellin listat dhe Gjykata Kushtetuese, e cila solli listën e saj me anëtarët e zgjedhur në atë moment në detyrë, po ashtu dhe KLGJ dhe KLP dërgoji listat e tyre. Për të qenë korrekt në zbatimin e ligjit, si organ emërtese që hidhte shortin për zgjedhjen e KED, që çdo gjë është publike dhe ne e kemi në *website* tonë, ne kemi kryer verifikim të thelluar kur është hedhur shorti për zgjedhjen e KED 2020. Sepse ligji e përcakton fare qartë se në momentin e hedhjes se shortit që është shumë larg në kohë nga momenti i marrjes se listës. Lista e kandidatëve vjen deri në 15 nëntor, ndërkohë që shorti hidhet midis datës 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti nga Presidenti, dhe deri në datë 10 dhjetor nga Kuvendi. Për të gjithë ju anëtarë të KED, që jeni zgjedhur me short, por edhe për atë pjesën tjetër qe ishte në lista, ne kemi kërkuar informacion deri në datën 4 dhjetor nga KLGJ dhe KLP dhe nga Prokuroria. Kjo edhe për arsye se z. Dvorani ne atë moment ishte kallëzuar nga Presidenti për veprime të konsideruara si shpërdorim detyre. Kjo është e vërtetë. Ka ardhur lista me përgjigje nga Prokuroria, ky person që ushtron funksionin e gjyqtarit te Gjykatës së Lartë nuk figuron i regjistruar ne regjistrin e njoftimit te veprave penale. Sepse ne e dimë shumë mirë çdo të thotë një vepër, e çdo të thotë një autor, kur këto të dyja bëheshin bashkë në kallëzim dhe nuk ishin ndarë. Prokuroria e solli ashtu përgjigjen dhe short për Gjykatën e Lartë nuk është hedhur dhe është sqaruar në rezultatet e shortit në proces-verbalin që kemi dërguar dhe KED që, për Gjykatën e Lartë nuk ka anëtar zëvendësues sepse i vetmi anëtar ishte z.Dvorani. S’ka short, automatikisht, apriori *ex lege* zoti Dvorani u zgjodh anëtar, dhe filloi KED të funksionojë. Më pas dihet se çfarë ka ndodhur. Pra Presidenti përveçse organ

emërtese i emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, mori këtë vit dhe cilësinë e organit të emërtesës për KED, pasi ishte institucioni që hodhi shortin për zgjedhjen e tij. Presidenti kishte dhe me ligjin e vjetër dhe me ligjin e ri të drejtën e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Ndërkohë që me ligjin e vjetër me të cilin ishte emëruar z.Dvorani kishte dy cilësi, edhe te konstatonte përfundimin e mandatit se bashku me Kryetarin e Gjykatës se Larte dhe ky fakt kishte ndodhur për z.Dvorani qe ne vitin 2014. Me prurjen e datës 05.03.2020 te tre propozimeve të KLGJ-sw dhe emwrimin e tyre, Presidenti vlerësoi se në këtë moment vendi që mbante z.Dvorani konsiderohej i plotësuar dhe për ato arsye që ne i kemi thënë edhe në letrën që kemi sjellë, ishim në pritje të veprimeve te tij administrative për dorëzimin e detyrës, e cila rrjedhimisht do te kishte efekt dhe për detyrën që mbante ne KED. Kjo nuk u krye nga zoti Dvorani. Atëherë ishte i detyruar Presidenti i Republikës të bënte një kërkesë që nuk e di, sekretaria mund ta verifikojë me nr. 1117/2 prot dt. 10.04.2020 qe i është drejtuar KLGJ, gjyqtareve ne detyre te Gjykatës se Larte, Kuvendit, anëtareve te KED te gjithëve, Gjykatës Kushtetuese dhe Av.Popullit. Nuk lamë institucion pa e dërguar, e dërguam tek të gjithë, që të gjithë të merrnin informacion mbi qëndrimin e institucionit kushtetues qe ka zgjedhur KED, por dhe të organit të emërtesës për emërimin e gjyqtarit te Gjykatës se Larte. Nuk e di nëse e kane marre te gjithë anëtarët këtë letër? Të paktën ta verifikojnë, nëse z.Dvorani e ka shpërndarë sepse ai administronte posten dhe ka marre dijeni për këtë. Kjo u anatemua ne mënyre jo korrekte nga z.Dvorani publikisht mediatikisht, me anë të atyre letrave qe tha dhe znj.Ballanca qe dilnin ne media here pas here. Ne kishim mbajtur një qëndrim zyrtar shtetëror. Nëse Presidenti s’do te kishte bërë atë letër (letra e datës 10 prill) do të ishim në vitin e 17-të, e kusur të ushtrimit të mandatit si gjyqtar i Gjykatës se Larte në mënyre të padrejtë. Bashkë me këtë letër ne kemi shprehur qëndrimin dhe si organ emërtese se çfare efekte sjell ndërprerja e ushtrimit te detyrës e të mandatit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë që kishte kohë që kishte mbaruar. Për ne ka mbaruar që në 11 apo 12 gusht 2016 për atë pune, që kur doli vendimi i Gjykatës Kushtetuese bashke me ndryshimet kushtetuese, por në logjiken e ngritur prej tij publikisht dhe në KED, me hyrjen ne këtë institucion që quhet Gjykata e Lartë te 3 gjyqtarëve rinj, bashkë apo tek e tek secili, mandati i tij konsiderohej i përfunduar dhe bashke me të dhe e drejta për të qëndruar në detyrë. Dhe Këshillit i kërkohet ajo që i kërkohet për te ruajtur legjitimitetin e funksionimit te tij sepse do të cenoje disa parime, që të mos zgjatem më shumë. U anatemua si shkresë, dhe KLGJ për disa probleme teknike e zgjati shqyrtimin e saj në 1,2,3 4 mbledhje. Mbledhja e fundit ka qenë në date 11 qershor dhe kjo mbledhje e KLGJ është bërë publike. Ne kemi marre pjesë si të ftuar në këtë mbledhje dhe në të, kanë qenë përfaqësues te USAID po njëherë, të EURALIUS dhe

mediatikisht është ndjekur *live*. Në këtë mbledhje u vendos se, kishte përfunduar detyrimi i zotit Dvorani për të qëndruar në detyrën e Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Kështu e quajti KLGJ në atë moment. Kemi qenë pjesëmarrës në mbledhje, ndërkohë mbas datës 11 tashmë sipas KLGJ po flasim jo sipas Presidentit që pretendonte diçka, u ndërpre mandati. Njoftohet zoti Dvorani në datë 1 korrik që ky vendim u morr dhe ku edhe pse i kundërshtoi ato që kishte shkruajtur Presidenti dhe ato diskutime e vendimarrje të KLGJ, duke pretenduar publikisht që do ti dërgonte në gjyq, duke anatemuar çfarë janë këto që bën Presidenti, që ndërhyjnë në organet e pavarura?, kur Presidenti emëron gjyqtarin e Gjykatës së Lartë!, pjesë e procesit të zgjedhjes së KED. Zotëria në fjalë deklaronte ç'punë ka Presidenti që do të më heq mua të drejtën të shtoj dhe nja 1 vit tjetër në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, që e kishte emëruar po Presidenti në atë detyrë, që po Presidenti ia kishte konstatuar përfundimin e mandatit që në shkurt 2014. Ndërkohë që Presidenti në përmbushje të detyrës kushtetuese, po ngrinte një shqetësim: çfarë po ndodh në Gjykatën e Lartë? Se një mandat i ushtruar në kundërshtim me Kushtetutën nga zoti Dvorani, rrezikon të prodhojë dhe pasoja ekonomike. Këto fakte në letrat tona janë cituar të gjitha edhe me shprehjen e vullnetit të tij se ai pranoi të emërohej gjyqtar në Gjykatën e Apelit. Është e drejta e tij të vlerësojë këtë situatë, është e drejtë dhe detyrë e KLGJ të vlerësojë përmbushjen e kushteve dhe kriterëve nëse ky shtetas tashmë i plotëson kushtet, për të emëruar atje (Gjykatën e Apelit). Pra në përfundim, ai (zoti Dvorani) pranoi qëndrimin e Kreut të Shtetit, që në këtë rast është organ emërtese qoftë për zgjedhjen me short për në KED, edhe për zgjedhjen e tij në Gjykatën e Lartë. Z. Dvorani pranoi qëndrimin e KLGJ. Në këtë mënyrë gjithë pretendimin që ai ngrinte në fund të këtij njoftimi që ne si institucion e morëm ditën e djeshme në darkë, sepse nuk e kishim, e kishim parë nga media, jemi njohur mediatikisht me të gjitha, por zyrtarisht jo. Përmes këtij kërkimi ai e fut KED në një qorrsokak që ju vet e pranuat në diskutimin tuaj, se KED nuk ka baze ligjore për të shqyrtuar. Ai citon në kërkimin e tij se, unë nuk do të vij në mbledhje deri sa ju të merrni një vendim për këtë çështje. Ç'ka do të thotë, duke ecur automatikisht me logjikën që znj. Ballanca e tha shumë bukur të qëndrimit të tij, ai me këtë ka thënë që, unë nuk vij më, sepse po vetë ka thënë që KED nuk ka detyrë të merret me këtë punë, por është detyrë e organit të emërtesës që ka zgjedhur me short KED. Pra e Presidentit i cili e ka mbajtur tashmë një qëndrim zyrtar mbi këtë çështje. Këtë qëndrim po të dëshirojë ta kundërshtojë z. Dvorani, e ka rrugën e hapur në gjykatë të, për këto muaj që i kanë ngelur këtij KED, kohë për të ekzekutuar mandatin. Të themi që i ka kaluar afati për të kundërshtuar këtë qëndrim, apo jo, këtë le të gjejë gjykatë. Por të mos ngatërrojë KED në këtë mënyrë dhe ta vendosi atë në këtë situatë ku të gjithë kandidatët dhe jo vetëm kandidatët, por aktorë të ndryshëm të interesuar

për implementimin e sistemit mund të kundërshtojnë dhe të deligjitimojnë punën e KED. Në për këtë jemi shumë të shqetësuar, se do të deligjitimohet. Sepse ndërkombëtarisht u faktua që veprimet e ish-Kryetarit sollën një incident të rëndë procedural, incident aq te madh sa u vu në dyshim anëtari i Gjykatës Kushtetuese. Sa u desh të angazhohej Komisioni i Venecias, ti vinte disa pika mbi “i” dhe të krijonin ne *deadline* për funksionimin e këtyre organeve dhe të KED. Kështu që, Presidenti ngelet në të njëjtin qëndrim dhe për këto veprime që z.Dvorani ka bërë, ja ku e kemi dhe shkresën, ja dërgoi dhe prokurorisë SPAK edhe njëherë, tashme duke kërkuar nga Prokuroria që të vlerësojë, dhe prokuroria duhet ta bëjë këtë, që referuar këtyre sjelljeve është mirë që ta rivlerësoje mundësinë nëse ky shtetas duhet apo mund t’i nënshtrohet masave të sigurimit personal dhe kufizimit të çdo funksioni publik derisa të mbyllet hetimet. Se dhe hetimet vajtën 10 muaj, që nuk po merret vesh se çfarë po bëhet. Se çështjet për të cilat është akuzuar janë shumë të rënda, për Gjykatën Kushtetuese, nuk është shaka, nuk është shaka vërtet, përplasje, përplasje dhe ku doli, Presidenti kishte plotësisht të drejtë. Prandaj Presidenti ka qenë i shqetësuar bashkë me çështjet e tjera të evidentuara në këtë letër, e ka kërkuar vëmendjen e Këshillit dhe kujdesin e tij që të zbatohet kushtetutën, ligjin dhe të mos rrëshkasë në paligjshmëri që do të sillte pastaj pasoja edhe më të rënda. Ju faleminderit për kohën dhe ndjesë.

**Michele Lakony** merr fjalën: “Faleminderit që më bëtë pjesë të kësaj mbledhjeje sot. Ka qenë një vit sfidues për KED dhe për të gjithë ne dhe për gjithë të tjerët. Në 2020 KED ka qenë pjesë dhe e vlerësimeve dhe të Komisionit të Venecias duke ushtruar kontrollin e një procesi që ka qenë gjerësisht i diskutuar dhe i sfiduar dhe nga të tjerë. Një sfidë e shtuar ka qenë dhe pandemia e cila solli dhe ndalime dhe kufizime të caktuara në mbledhje të ndryshme për KED dhe për institucione të tjera të Shqipërisë. Pavarësisht dëshirës tuaj personale për të vijuar me procesin ashtu si duhet këto faktorë kanë ndikuar detyrimisht në ngadalësimin e vijueshmërisë të procesit të verifikimit. Risi tjetër për ju ka qenë dhe ndryshimi i kryetarit të këtij organi përgjatë këtij viti. Te gjithë këta faktorë kanë ndikuar për ta bërë punën tuaj edhe më të vështirë. Për sa i përket çështjes aktuale që është përpara Këshillit për diskutim jam i mendimit që nuk është KED për të përcaktuar mandatin e anëtareve të tij. Kompetenca juaj është për të vlerësuar kandidatet që ju paraqiten ju nga organet e tjera. Faktorët dhe kriteret që ndikojnë në vendimmarrjen tuaj janë të përcaktuara në ligj dhe janë të përcaktuara në kohe, gjatë momentit që hidhet shorti. Kjo nuk do të thotë se çdo situatë është e lehtë. Janë skenarë të ndryshëm që paraqiten përpara jush dhe diskutohen në mënyra të ndryshme, u diskutua ku anëtarët shkarkohen ose kur ndryshojnë pozicionet gjatë mandatit ku ushtrojnë detyrën. Siç e dini dhe nga opinionet e gjyqtareve dhe



te juristeve ka interpretime te ndryshme për çështjet qe paraqiten duke pare dhe opinionet e shprehura nga ana e anëtareve shihet qe analiza është e duhura ajo qe u tha. Absolutisht unë jam thjesht një vëzhguese ne këtë proces nuk jam anëtare me te drejte vote dhe skam ardhur me një analize te gjere përpara jush por e vlerësoj mundësinë e dhëne për tu shprehur ne këtë moment”.

**Vitore Tusha** iu drejtohet anëtarëve duke i pyetur, nëse vlerësojnë se duhet te këtë një vendimmarrje në lidhje me këtë çështje apo të qëndrojë si një diskutim?

**Ludovik Dodaj** shprehet se nuk marrin dot vendim.

**Fiona Papajorgji:** Secili nga ne e shprehu opinionin. Edhe në datën 15.01.2020 nuk kemi marre vendim.

**Vitore Tusha** pyet nëse janë dakord.

**Bledar Dervishaj** rimerr fjalën: “Ka një implikim kjo, mosmarrja vendim apo njoftim. Po bëjmë diskutim hapur. Unë e kuptova qasjen e Këshillit që nuk është kompetencë e Këshillit për ta shqyrtuar kërkesën e z.Dvorani. U kuptua dhe nga shprehja e mendimit. Së pari, a do të këtë njoftim të z.Dvorani për këtë qëndrim të Këshillit? Apo Këshilli do t'i ktheje një përgjigje që u diskutua dhe unanimisht dakortësoi që nuk është në kompetencën e këshillit. Në të dyja logjikat ne kemi pasur kujdes kur kemi hartuar shkresën se jo vetëm një veprim apo vendim, por edhe ndonjë mundësi që të lerë hapur shtegun e interpretimit qe z.Dvorani paraqet këtu, përkundrejt asaj që thotë po vetë, “unë nuk do vi deri sa ju të merrni një vendim”. Duhet shmangur patjetër ky risk. Sepse nëse fizikisht po flasim hapur do të paraqitet Dvorani, ky Këshill e njeh si anëtar? Se organi i emërtesës që e zgjodhi (Presidenti) nuk e njeh. Duhet të jetë i qartë Këshilli në këtë rast për të mos lënë shtigje që zakonisht gjenden lehtë të interpretohen e të bëjnë prezencë të pambështetura as në Kushtetutë as në ligj. Këtë e kisha merak. E kemi thënë në shkresë po ta lexojmë, ju e keni lexuar, por unë më duhej ta sillja sërish në vëmendje.

**Vitore Tusha** lidhur me kërkesën e z. Dvorani që të merret një vendim nga Këshilli thotë se anëtarët u shprehën dhe nuk e vlerësojnë marrjen e një vendimi për një çështje që nuk është kompetencë e Këshillit .

**Erinda Ballanca** thotë se mund t'i drejtohen organit kompetent për të marrë vendim. Ta zgjedhë ai organin kompetent.

**Bledar Dervishaj** thotë: “Problemi është nëse do të jetë njoftim zyrtar në akt apo njoftim publik që bëni ju?”.

**Saida Dollani** rimerr fjalën: “Unë jo pa qëllim kur mora fjalën, thashë i bindem rendit që juve znj.Kryetare keni përcaktuar. Pse e thashë këtë? Sepse njoftimi apo shkresa që ka

sjellë z.Dvorani me sinqeritetin më të madh e them që nuk e kam lexuar sepse nuk hyn në fushën time të leximit, nuk hyn fare. Unë jam burim njerëzor, unë energjitë e mia do t'i çoj atje ku ligji me urdhëron dhe unë jam këtu për të zbatuar ligjin'. Në vijim vazhdon fjalën duke u shprehur se çdo vendimmarrje në lidhje me sa kërkohet nga z. Dvorani do të jetë inekzistente, pasi në kompetencën e KED është verifikimi i kushteve ligjore dhe vlerësimi i kandidatëve sipas listave të sjella nga Presidenti dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.”

**Vitore Tusha** deklaroi të mbyllur mbledhjen që i përket rendit të ditës, pikat 1, 2, 3, 4 për të vazhduar më pas anëtarët dhe Av. i Popullit me pikën 5 të rendit të ditës.

Zonja Tusha deklaroi se mbledhja e radhës do të jetë shumë shpejt.

**Mbledhja mbyllet në orën 18.18**

**Tiranë, më datë 16 Shtator 2020**

**SEKRETARE**

**Ermelinda KADIU**

**Dorina DULAJ**

**Vilma DOKUSHI**

**Elona KARDHIQI**

**ZV/ KRYETARE**

**Vitore TUSHA**